# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare**

**www.qbz.gov.al**

**Nr. 60 — 23 prill — 2013**


P Ë R M B A J T J A


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr. 258, datë 27.3.2013 | Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës "BOT", të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Vëllezërit Tola", sh.p.k., "Arti" sh.p.k., dhe "GPA Konstruksion" sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Gostimë ..... | 2593 |
| Vendim i KM nr. 322, datë 18.4.2013 | Për një shtesë në vendimin nr. 428, datë 9.6.2010 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet, dhe për procedurën e shitjes", të ndryshuar ..... | 2593 |
| Udhëzim i MF nr. 11, datë 6.4.2013 | Për disa shtesa në udhëzimin nr. 19, datë 1.9.2011 "Për modalitetet e aplikimit të pullave të akcizës dhe pullave fiskale në produktet e duhanit, birrës dhe alkoolit" ..... | 2594 |
| Urdhër i MD nr.44/3, datë 5.4.2013 | Për krijimin e Regjistrit Shtetëror të Akteve..... | 2595 |
| Vendim i GJK nr. 12, datë 16.4.2013 | Me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. ..... | 2599 |
| Vendim i GJK nr. 13, datë 16.4 2013 | Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën, të neneve 186 dhe 298 të Kodit Penal, në pjesën që parashikojnë dy dënime kryesore..... | 2606 |
| Vendim i GJK nr. 14, datë 17.4.2013 | Me objekt: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr.26, datë 5.4.2012 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8098, datë 28.3.1996 'Për statusin e të verbrit'";<br>Pezullimi i zbatimit të ligjit nr.26, datë 5.4.2012..... | 2611 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i GJK<br>nr. 15, datë 19.4.2013 | Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshëm me Kushtetutën të Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.2266, datë 27.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; të vendimit nr.10-2009-1031 (503), datë 8.12.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe të vendimit nr.00-2012-820, datë 12.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi)…… | 2620 |
| Vendim i GJK<br>nr. 16, datë 19.4.2013 | Me objekt: 1- Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, i vendimit nr. 00-2012-785, datë 5.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; vendimit nr. 1990, datë 4.10.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 2, datë 5.1.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.<br>2- Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.<br>3- Detyrimi i subjektit të interesuar, shoqëria "Alban Tirana Co" sh.p.k., që të kthejë sendin e marrë në pronësi dhe ngarkimi i përmbaruesit privat, Besnik Bajraktari, për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese..... | 2628 |

**VENDIM**
**Nr. 258, datë 27.3.2013**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS "BOT", TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE BASHKIMIT TË PËRKOHSHËM TË SHOQËRIVE "VËLLEZËRIT TOLA", SHPK, "ARTI" SHPK, DHE "GPA KONSTRUKSION" SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE NË RRJEDHËN E LUMIT GOSTIMË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21 pika 4 e 27 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Vëllezërit Tola" sh.p.k., "Arti" sh.p.k., dhe "GPA Konstruksion", sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentraleve në rrjedhën e lumit Gostimë, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr. 322, datë 18.4.2013**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 428, DATË 9.6.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRITERET E VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE, QË PRIVATIZOHET APO TRANSFORMOHET, DHE PËR PROCEDURËN E SHITJES", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008 "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve", miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas paragrafit të parë të pikës 33 të kreut III të vendimit nr. 428, datë 9.6.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

"Në rastet kur objekti i marrë me qira apo enfiteozë është shembur plotësisht dhe mbi truallin e tij është ndërtuar një objekt krejtësisht i ri apo në rastet kur objektit të marrë me qira/enfiteozë i janë bërë ndryshime, shtesa apo prishje të shumta që e bëjnë të vështirë vlerësimin real të tij, pasi objekti është tjetërsuar (të miratuara me aktin ligjor përkatës), vlerësimi i objektit të marrë me qira apo enfiteozë, si dhe genplani bëhen në bazë të dokumentacionit ekonomiko-teknik që

disponon institucioni shtetëror që e ka në administrim objektin, në bazë të çdo dokumentacioni tjetër të mundshëm që mund t'i shërbejë këtij vlerësimi, si dhe në bazë të kontratës së qirasë/entifeozës e të dokumentacionit përkatës bashkëlidhur saj (genplani, procesverbali i dorëzimit, fotografitë e objektit në momentin e marrjes me qira etj.).

Për qiramarrësit, që blejnë nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike objektin shtetëror (godinën), që e kanë pasur me qira, në rastet kur vlera e investimit është mbi 150% e vlerës së truallit, shlyerja e vlerës së objektit (godinës) të bëhet deri në 80% të vlerës së saj me bono privatizimi apo me lekë privatizimi, sipas kërkesës me shkrim, të depozituar në Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike) nga blerësi i objektit (godinës). Në këto raste, në fondin special të kompensimit të pronave kalohet vlera e shlyer në lekë. Në rastet kur pjesa e shlyer në lekë është më shumë se 65% e vlerës së objektit, në fondin special kalon vetëm 65% e vlerës totale të objektit.".

2. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, prefekti i qarkut dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**UDHËZIM**
**Nr. 11, datë 6.4.2013**

**PËR DISA SHTESA NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 1.9.2011 "PËR MODALITETET E APLIKIMIT TË PULLAVE TË AKCIZËS DHE PULLAVE FISKALE NË PRODUKTET E DUHANIT, BIRRËS DHE ALKOOLIT"**

Bazuar në nenet 40 deri 42 të ligjit 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 19, datë 1.9.2011 "Për modalitetet e aplikimit të pullave të akcizës dhe pullave fiskale në produktet e duhanit, birrës dhe alkoolit", bëhet këto shtesa:

1. Në pikën 4.1, paragrafi i parafundit ndryshohet me këtë përmbajtje:

Pullat e akcizës për duhanin do të vendosen në pjesën e pasme dhe të përparme të paketës. Pullat e akcizës për prodhuesit e tjerë të duhanit (d.m.th. purot dhe duhanin e grirë) do të vendosen mbi paketimin përkatës. Produkti "duhan i grirë" lejohet të tregtohet vetëm i ambalazhuar në paketime deri në 500 gr, me përjashtim të rasteve kur është i destinuar drejt një magazine fiskale, magazine doganore ose eksport. Janë të detyrueshme të pajisen me pullë të gjitha paketimet e duhanit të grirë, deri në 500 gr.

2. Në pikën 10.1 shtohen dy paragrafë si më poshtë:

Importuesit dhe prodhuesit e duhanit të grirë kanë afat deri në datën 15 maj 2013 për deklarimin e stokut pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe porositjen te furnizuesi i pullave të akcizës për pajisjen e të gjithë stokut me pullë (me akcizë të paguar ose jo). Pas përfundimit të këtij afati asnjë importues apo prodhues nuk do të lejohet të shesë apo të shpërndajë produktin "duhan i grirë" pa pullën e akcizës sipas këtij udhëzimi.

Duke filluar që nga data 15 qershor, asnjë produkt "duhan i grirë" nuk do të lejohet të qarkullojë/tregtohet pa pullën e akcizës sipas këtij udhëzimi.

3. Në aneksin 1, në pikën 1.4 pas togfjalëshit "si paketat e purove" shtohet togfjalëshi "dhe paketimet e duhanit të grirë".

Ky udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
**Ridvan Bode**

**URDHËR**
**Nr.44/3, datë 5.4.2013**

**PËR KRIJIMIN E REGJISTRIT SHTETËROR TË AKTEVE**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.96/2012 "Për Qendrën e Botimeve Zyrtare",

URDHËROJ:

1. Krijimin e regjistrit për pasqyrimin e të dhënave, për aktet shtetërore (më poshtë "regjistri").

2. Sektori i Botimeve të Tjera është struktura e autorizuar përgjegjëse, e cila caktohet për administrimin e Regjistrit, regjistron të dhënat për aktet shtetërore, pas miratimit të tyre.

3. Regjistri mbahet në dy forma:

a) në formën manuale (me shkrim);

b) në formën elektronike (digjitale).

4. Regjistri manual dhe ai elektronik kanë të njëjtin format standard të miratuar me këtë urdhër. Elementet e veçanta që karakterizojnë regjistrin elektronik nuk përbëjnë shmangie nga forma standarde e regjistrit dhe lidhen vetëm me paraqitjen elektronike të të dhënave. Rregullat e plotësimit të regjistrit manual dhe atij elektronik janë të njëjta.

5. Regjistri manual përbëhet nga 100 fletë formati "A3" të lidhura, të numërtuara e të vulosura në çdo faqe me vulën e Ministrisë së Drejtësisë. Kur një rresht nuk është i mjaftueshëm për të pasqyruar të dhënat e aktit, kalohet në faqen tjetër duke bërë shënimin përkatës në kolonën "shënime".

6. Në pjesën e pasme të faqes së fundit të çdo regjistri manual, Sektori i Botimeve të Tjera, i cili është përgjegjës për administrimin e Regjistrit, bën shënimin me shkrim dore:

"Ky regjistër përbëhet nga faqe të numërtuara e të vulosura, të cilat u kontrolluan e u sekretuan sot më datë (shënohet dita, muaji, viti, emri, mbiemri dhe nënshkrimi i punonjësit)."

Në fund, ky shënim vuloset me vulën e Ministrisë së Drejtësisë.

7. Kur një regjistër manual plotësohet, kalohet në regjistrin tjetër duke bërë shënimin në pjesën e pasme të faqes së fundit të regjistrit të plotësuar, si më poshtë:

"Ky regjistër u plotësua sot më datë (shënohet dita, muaji, viti, emri, mbiemri dhe nënshkrimi i punonjësit)."

8. Kur hapet një regjistër i ri manual, në shënimin që bëhet në faqen e fundit, sikurse parashikohet në pikën 7, shtohen edhe fjalët:

"Ky regjistër është vazhdim i regjistrit të plotësuar më datë (shënohet dita, muaji, viti, emri, mbiemri dhe nënshkrimi i punonjësit)."

9. Në rast se bëhen gabime materiale në hedhjen e informacionit në regjistër, rreshti elektronik dhe shkresor i shkruar gabim nuk fshihet, por vendoset statusi gabim/jo aktiv dhe regjistrohet një rresh i ri me të dhëna të sakta, i cili reflektohet në formatin elektronik dhe atë shkresor të regjistrit.

10. Çdo lloj akti, botimi i të cilit është i detyrueshëm sipas legjislacionit në fuqi, duhet të ketë regjistrin e vetë përkatës.

11. Çdo faqe e regjistrave në krye emërtohet "Regjistri Shtetëror i Akteve". Çdo fletë është e ndarë në 30 rreshta dhe në 11 kolona, sipas modelit të paraqitur në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij urdhri. Kolonat kanë emërtimet e mëposhtme:

a) nr. (numri rendor i kërkesës që do të regjistrohet);

b) data e pasqyrimit në regjistër;
c) institucioni përgjegjës, që ka propozuar aktin;
ç) numri i aktit;
d) data e miratimit të aktit;
dh) titulli i aktit;
e) korrektimet gjuhësore dhe juridike;
e) numri i Fletores Zyrtare dhe data e Fletores Zyrtare;
f) ndryshimet ose shtesat pas miratimit të aktit;
g) shfuqizimet;
gj) shënime (pasqyrohen të dhënat që nuk përfshihen në rubrikat e tjera dhe që çmohen se janë të rëndësishme për t'u pasqyruar, p.sh. kalimi në faqe tjetër, si rast përjashtimor, për efekt plotësimi, pasqyrohet shkurt arsyeja e shënimeve ose e ndryshimeve në të dhënat e regjistrit, si dhe data, muaji, viti, emri, mbiemri e nënshkrimi i personit që ka bërë shënime).

12. Në rastin e regjistrit në formën elektronike, germat "f" dhe "g" të pikës së mësipërme nuk do të paraqiten në formë kolone, por në rresht, me numër me fraksion poshtë aktit që ndryshojnë ose shfuqizojnë, në përputhje me shtojcën 2, bashkëlidhur.

13. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë dhe Qendra e Botimeve Zyrtare për zbatimin e këtij urdhri.

14. Ngarkohet sektori i arkiv-protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
**Eduard Halimi**

Shtojca 1

| Nr. | Data | Institucioni përgjegjës që ka propozuar aktin | Numri i aktit | Data e miratimit të aktit | Titulli i aktit | Korrektimet gjuhësore dhe juridike | Numri dhe data e fletores zyrtare | Ndryshimet ose shtesat pas miratimit të aktit | Shfuqizimet | Shënimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | | | | | | |
| 2 | | | | | | | | | | |
| 3 | | | | | | | | | | |
| 4 | | | | | | | | | | |
| 5 | | | | | | | | | | |
| 6 | | | | | | | | | | |
| 7 | | | | | | | | | | |
| 8 | | | | | | | | | | |
| 9 | | | | | | | | | | |
| 10 | | | | | | | | | | |
| 11 | | | | | | | | | | |
| 12 | | | | | | | | | | |
| 13 | | | | | | | | | | |
| 14 | | | | | | | | | | |
| 15 | | | | | | | | | | |
| 16 | | | | | | | | | | |
| 17 | | | | | | | | | | |
| 18 | | | | | | | | | | |
| 19 | | | | | | | | | | |
| 20 | | | | | | | | | | |
| 21 | | | | | | | | | | |
| 22 | | | | | | | | | | |
| 23 | | | | | | | | | | |
| 24 | | | | | | | | | | |
| 25 | | | | | | | | | | |
| 26 | | | | | | | | | | |
| 27 | | | | | | | | | | |
| 28 | | | | | | | | | | |
| 29 | | | | | | | | | | |
| 30 | | | | | | | | | | |

Shtojca 2

| Nr. | Data | Institucioni pergjegjës që ka propozuar aktin | Numri i aktit | Data e miratimit të aktit | Titulli i aktit | Korrektimet gjuhesore dhe juridike | Numri dhe data e Fletores Zyrtare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | | | |
| 2 | | | | | | | |
| 3 | | | | | | | |
| 4 | | | | | | | |
| 5 | | | | | | | |
| 6 | | | | | | | |
| 7 | | | | | | | |
| 8 | | | | | | | |
| 9 | | | | | | | |
| 10 | | | | | | | |
| 11 | | | | | | | |
| 12 | | | | | | | |
| 13 | | | | | | | |
| 14 | | | | | | | |
| 15 | | | | | | | |
| 16 | | | | | | | |
| 17 | | | | | | | |
| 18 | | | | | | | |
| 19 | | | | | | | |
| 20 | | | | | | | |
| 21 | | | | | | | |
| 22 | | | | | | | |
| 23 | | | | | | | |
| 24 | | | | | | | |
| 25 | | | | | | | |
| 26 | | | | | | | |
| 27 | | | | | | | |
| 28 | | | | | | | |
| 29 | | | | | | | |
| 30 | | | | | | | |

**VENDIM**
**Nr. 12, datë 16.4.2013**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Bashkim Dedja | Kryetar i Gjykatës Kushtetuese |
| Vitore Tusha | Anëtare e " " |
| Sokol Berberi | Anëtar i " " |
| Admir Thanza | Anëtar i " " |
| Altina Xhoxha | Anëtare e " " |
| Fatmir Hoxha | Anëtar i " " |
| Vladimir Kristo | Anëtar i " " |

me sekretare Blerina Basha, në datën 29.1.2013, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 54/26 Akti, që i përket:

KËRKUES: Feta Bundo, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga avokat Xhemal Gazidede.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, z. Flamur Gjymishka.

Zyra Përmbarimore Tiranë, përfaqësuar nga kryetari i Zyrës, z. Arjan Bylykbashi.

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f, 132/1, dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 41 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nenet 27, 28, 49 dhe 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, shqyrtoi pretendimet dhe komentet e kërkuesit; prapësimet e subjekteve të interesuara, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe të Zyrës Përmbarimore Tiranë, dhe pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesi ka punuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, në detyrën e Shefit të Sektorit të Borxhit në Drejtorinë e Procedurave, detyrë të cilën e ka kryer deri në daljen e aktit administrativ nr. 3623/5, datë 18.11.2004, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, për pezullimin e tij nga detyra. Më vonë, me aktin administrativ nr. 10251/9, datë 11.8.2005, Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Doganave ka vendosur marrjen e masës disiplinore të largimit të kërkuesit nga shërbimi civil.

2. Kërkuesi ka kundërshtuar aktet administrative të lartpërmendura në Komisionin e Shërbimit Civil (KSHC), i cili, me vendimin nr. 201, datë 30.9.2005, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 10251/9, datë 11.8.2005 për largimin nga shërbimi civil të kërkuesit dhe shfuqizimin pjesërisht të aktit nr. 3623/5, datë 18.11.2004, në lidhje me shkakun dhe kohëzgjatjen e pezullimit nga detyra të kërkuesit, duke lënë në fuqi gjendjen e pezullimit deri në momentin kur prokuroria apo gjykata të japin një vendim përfundimtar.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka kundërshtuar vendimin e KSHC-së, duke kërkuar shfuqizimin e tij dhe lënien në fuqi të akteve administrative të Drejtorit dhe Zëvendësdrejtor të Përgjithshëm të Doganave.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendim nr. 17, datë 15.3.2005, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, si të pabazuar në prova dhe ligj.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2007-846 (873), datë 22.6.2007, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

6. Ndërkohë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin e datës 27.10.2005, ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të kërkuesit.

7. Pas vendimit të Gjykatës së Lartë, kërkuesi, me shkresë prot. nr.4199, datë 23.04.2009, i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, duke kërkuar rikthimin në punë. Në përgjigje të kësaj kërkese, me shkresë prot. nr. 10634/2, datë 27.11.2007, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave sqaron kërkuesin se nuk mund të kryhet rikthimi i tij në punë për shkak të mungesës së vendeve të lira në institucion.

8. Në këto kushte kërkuesi fillon procedurat e ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 17, datë 15.3.2006, të Gjykatës së Apelit Tiranë. Kjo e fundit, me vendimin nr. 126, datë 13.11.2008, ka vendosur lëshimin e urdhrit të ekzekutimit të vendimit të lartpërmendur.

9. Pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, kërkuesi, në datën 13.4.2009 i është drejtuar Zyrës Përmbarimore Tiranë për ekzekutimin e vendimit nr. 126, datë 13.11.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

10. Zyra e Përmbarimit Tiranë, me shkresën nr. 7593 prot., datë 21.5.2009, në respektim të ligjit, ka nisur procedurën e lajmërimit për ekzekutim vullnetar të urdhrit të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me shkresë nr. 6874/1, datë 30.6.2009, drejtuar Zyrës së Përmbarimit Tiranë dhe për dijeni kërkuesit, z. Feta Bundo, ka sqaruar se nuk ka çfarë të ekzekutojë, sepse vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe ai i KSHC-së nuk përmbajnë asnjë detyrim për të ekzekutuar, nga momenti që ato nuk kanë përcaktuar rregullimin e pasojave që rrjedhin nga shfuqizimi i urdhrit nr. 10251/9, datë 11.08.2005, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

12. Me shkresë të datës 23.1.2010, kërkuesi i është drejtuar përsëri Zyrës së Përmbarimit Tiranë për të vazhduar me ekzekutimin e detyrueshëm të urdhrit të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, por nga kjo zyrë nuk rezulton të jenë ndërmarrë veprime të mëtejshme.

13. Ndërkohë kërkuesi i është drejtuar me shkresa të ndryshme për rikthim në punë, pra për ekzekutimin e vendimit nr. 17, datë 15.3.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë, edhe Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, Avokatit të Popullit dhe Ministrit të Financave, por ka hasur gjithmonë në pasivitetin e autoriteteve të ngarkuara nga ligji në zbatimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Për këtë arsye, kërkuesi, në datën 4.10.2012, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim "Gjykata").

14. Po në datën 4.12.2012, Zyra e Përmbarimit Tiranë, me shkresë prot. nr. 8505, ka nisur procedurën e ekzekutimit të detyrueshëm të urdhrit të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

II

15. Përpara kësaj Gjykate, ***kërkuesi*** ka pretenduar cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Ai parashtron se moszbatimi i vendimit nr. 17, datë 15.03.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë i ka mohuar të drejtën për të punuar në administratën publike si dhe të drejtën për t'u dëmshpërblyer për dëmet ekonomiko – financiare të shkaktuara nga qëndrimi për rreth 7 vjet pa punë.

16. Subjekti i interesuar, ***Drejtoria e Përgjithshme e Doganave***, me shkresë nr. 20827/1 prot., datë 21.12.2012, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur këto prapësime:

16.1. Kërkuesi, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, nuk legjitimohet për t'iu drejtuar Gjykatës pasi nuk ka shteruar mjetet ligjore në dispozicion për këtë qëllim. Sipas subjektit të interesuar, kërkuesi, pas vendimit të Prokurorisë duhej t'i drejtohej sistemit të zakonshëm gjyqësor për rivendosjen e të drejtave të fituara nga largimi nga shërbimi civil. Në këtë drejtim, gjykatat e sistemit të zakonshëm duhet të përcaktojnë saktësisht detyrimin e debitorit në mënyrë që ai të jetë i ekzekutueshëm.

16.2. Po ashtu, kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës, sepse ai nuk ka respektuar afatin kohor dyvjeçar të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Vendimi i Gjykatës së Apelit, objekt shqyrtimi, është i datës 15.3.2006, ndërsa urdhri i ekzekutimit, i po kësaj gjykate, është i datës 13.11.2008. Edhe vendimi i Gjykatës së Lartë, datë 22.6.2007, është jashtë afatit dyvjeçar nga momenti kur kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

16.3. Ekzekutimi i vendimit nr. 17, datë 15.3.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë, është i pamundur, pasi ky vendim, dhe ai i KSHC-së, nuk përmbajnë asnjë detyrim për të ekzekutuar në lidhje me rikthimin në punë të kërkuesit apo dëmshpërblimin e tij. Vendimet në fjalë nuk kanë përcaktuar rregullimin e pasojave që rrjedhin nga shfuqizimi i urdhrit nr. 10251/9, datë 11.8.2005 të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

17. Subjekti i interesuar, ***Zyra Përmbarimore Tiranë***, me shkresë nr. 8749 prot., datë 17.12.2012, ka parashtruar se kjo zyrë ka filluar procedurat në lidhje me ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv dhe se do të vazhdojë këto procedura deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit.

III

***Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese***

18. Gjykata, përpara se të analizojë themelin e kërkesës, vlerëson të arsyeshme të ndalet fillimisht te pretendimet e përfaqësuesit të subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për sa i takon legjitimimit të kërkuesit para kësaj Gjykate.

***A. Lidhur me legjitimimin e kërkuesit***

19. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave pretendon se kërkuesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore të ankimit, si kusht për t'iu drejtuar Gjykatës. Vendimi i KSHC-së dhe ai i Gjykatës së Apelit nuk kanë disponuar mbi rivendosjen e të drejtave të tij për rikthimin në punë dhe dëmshpërblimin. Për këtë arsye, kërkuesi duhej t'i drejtohej fillimisht sistemit të zakonshëm gjyqësor për mbrojtjen e të drejtave të tij.

20. Gjykata Kushtetuese çmon se, ndryshe nga pretendimi i subjektit të interesuar, kërkuesi legjitimohet në kërkesën e tij drejtuar kësaj Gjykate.

21. Kërkuesi, në bazë të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", i është drejtuar KSHC-së dhe ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave për pezullimin nga detyra dhe më vonë për largimin e tij nga puna. KSHC-ja ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 10251/9, datë 11.8.2005 të Drejtorit i Përgjithshëm të Doganave për largimin nga shërbimi civil të kërkuesit dhe shfuqizimin pjesërisht të aktit nr. 3623/5, datë 18.11.2004, në lidhje me shkakun dhe kohëzgjatjen e pezullimit nga detyra të kërkuesit, duke lënë në fuqi gjendjen e pezullimit deri në momentin kur prokuroria apo gjykata të japin një vendim përfundimtar. Sipas ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën e Apelit, gjë të cilën e ka bërë subjekti i interesuar. Gjykata e Apelit Tiranë ka lënë në fuqi vendimin e KSHC-së. Rekursi i ushtruar në Gjykatën e Lartë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk është pranuar. Ndërkohë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të kërkuesit.

22. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë për të lëshuar urdhrin me qëllim ekzekutimin e vendimit të KSHC-së. Pas vendimit të Gjykatës së Apelit për lëshimin e urdhrit ekzekutiv, kërkuesi i është drejtuar Zyrës së Përmbarimit Tiranë për ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Kjo e fundit ka nxjerrë vendimin për ekzekutimin vullnetar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, e cila nuk ka pranuar të ekzekutojë asnjë pjesë të detyrimit.

23. Gjykata vlerëson se është i pabazuar argumenti i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave se kërkuesi duhej t'i ishte drejtuar gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për rivendosjen e të drejtave të fituara nga largimi nga shërbimi civil. Detyrimi i debitorit kundrejt kërkuesit është i përcaktuar ose i përcaktueshëm. Në këtë drejtim, largimi i nëpunësit civil nga detyra mbi bazën e një vendimi të paligjshëm, i cili si i tillë është shfuqizuar nga KSHC-ja, presupozon rikthimin në punë të nëpunësit, kërkuesit në rastin objekt shqyrtimi. Pikërisht për këtë arsye (rikthimi në punë i nëpunësit) vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 306, datë 13.6.2000 "Për disiplinën në shërbimin civil", pika 14, sanksionon

mënyrën e rregullimit të marrëdhënieve financiare në këtë rast, duke parashikuar se: *"Në rastin kur ndaj nëpunësit është marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil dhe Komisioni vendos shfuqizimin apo ndryshimin e vendimit të eprorit të drejtpërdrejtë, nëpunësi merr pagën e plotë që nga çasti kur janë ndërprerë marrëdhëniet financiare."* Ndërsa, për sa i përket pezullimit nga detyra, neni 22 i ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" parashikon se "*Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënieve ligjore për periudhën sa zgjat arsyeja e ndërprerjes. Në mbarim të kësaj periudhe nëpunësi civil rimerr vendin e tij në shërbimin civil, me përjashtim të rastit kur dënohet me heqje lirie*".

24. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendim të datës 27.10.2005, ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të kërkuesit. Si rrjedhojë, përderisa arsyeja e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nuk ekziston më, si dhe është shfuqizuar vendimi i largimit nga shërbimi civil, Gjykata vlerëson se kërkuesi ka fituar të drejtën e rikthimit në punë si dhe të pagës së plotë nga koha e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare. Pra, si përfundim, Gjykata çmon se kërkuesi i ka ezauruar të gjitha mjetet ligjore për t'iu drejtuar kësaj Gjykate.

25. Lidhur me pretendimin tjetër të subjektit të interesuar, se kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës sepse ai nuk ka respektuar afatin kohor dyvjeçar të parashikuara nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", Gjykata vlerëson se, ndryshe nga sa parashtron Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, afati dyvjeçar, i sanksionuar nga ligji organik i kësaj Gjykate, nuk zbatohet në kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

***B. Lidhur me themelin e kërkesës***

26. Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (*shih vendimet nr. 35, datë 27.10.2010; nr. 23, datë 17.5.2010; nr. 1, datë 19.1.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

27. Gjykata, në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka theksuar se ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Procesi i vendosjes në vend të një të drejte të shkelur përfshin jo vetëm vendimmarrjen e gjykatave, por edhe veprimet konkrete të organeve përgjegjëse të ngarkuara me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por vonesa nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës.

28. Gjykata ka rikonfirmuar qëndrimin se në një çështje që përfshin përcaktimin e një të drejte civile, kohëzgjatja e procedurave normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procedurës gjyqësore, deri në momentin kur jepet vendimi dhe ekzekutohet ai. Faza ekzekutive konsiderohet si fazë e mëtejshme e të njëjtit proces.

29. Gjithashtu, Gjykata, duke u mbështetur edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), është shprehur se kohëzgjatja e arsyeshme e procedimeve duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të çështjes dhe duke marrë në konsideratë kompleksitetin e çështjes, sjelljen e aplikantit dhe autoriteteve përkatëse si dhe interesin e aplikantit. Për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara, volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme. Ndërsa, për sa i përket sjelljes së autoriteteve, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjykimeve me shpejtësi të mjaftueshme *(shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 8, datë 23.3.2010; nr. 9, datë 1.4.2009; nr. 1, datë 19.1.2009*).

30. Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitura, Gjykata vlerëson se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo kompleksitet që mund të justifikojë një vonesë në ekzekutimin e vendimit, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuesit është me rëndësi në këtë kontekst.

31. Në këtë drejtim, Gjykata çmon se është e nevojshme fillimisht të vlerësohet nëse Zyra e Përmbarimit Tiranë ka marrë masat e nevojshme për zbatimin e urdhrit të ekzekutimit në përputhje me vendimin gjyqësor të formës së prerë, nr. 17, datë 15.3.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas kërkesës dhe dokumenteve të bashkëlidhura, rezulton se Zyra e Përmbarimit Tiranë është mjaftuar me lajmërimin për ekzekutim vullnetar nr. 7593 prot., datë 21.5.2009, dhe se nuk ka vazhduar të ndërmarrë hapat e mëtejshëm proceduralë, të nevojshëm për ekzekutimin e këtij vendimi. Vetëm pasi kërkuesi i është drejtuar kësaj Gjykate dhe pothuajse pas dy vjet e gjysmë nga lajmërimi për ekzekutim vullnetar, në datën 4.12.2012, Zyra e Përmbarimit Tiranë ka nisur procedurën për ekzekutim të detyrueshëm të urdhrit të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

32. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se Zyra e Përmbarimit Tiranë, në mënyrë të njëanshme dhe në kundërshtim me nenet 615 dhe 616 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), e gjendur përballë pretendimit të pamundësisë për të ekzekutuar vendimin gjyqësor të formës së prerë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, ka ndërprerë, pa asnjë justifikim ligjor, procedurat për ekzekutimin e vendimit për më shumë se 2 vjet. Si rrjedhojë, edhe pse Zyra e Përmbarimit ka rinisur procedurat për ekzekutimin e detyrueshëm dhe, në prapësimet e saj parashtron se do të vazhdojë procedurat përmbarimore deri në ekzekutimin e plotë të vendimit, Gjykata çmon se vonesat në ekzekutim nuk janë të justifikuara.

33. Në lidhje me sjelljen e autoritetit tjetër, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Gjykata çmon se pretendimi i saj se është në pamundësi të ekzekutojë vendimin e formës së prerë për shkak se ai, si titull ekzekutiv, është i paqartë dhe nuk përmban asnjë detyrim ndaj palës debitore, është i pabazuar. Nisur nga sa u tha më sipër (shih paragrafët 21-24), Gjykata, përkundrazi, vlerëson se vendimi i KSHC-së është i qartë dhe konkret. Ky vendim ka shfuqizuar tërësisht aktin për largimin nga shërbimi civil të kërkuesit si dhe ka shfuqizuar pjesërisht aktin e pezullimit nga detyra të tij, duke lënë në fuqi gjendjen e pezullimit deri në momentin kur prokuroria apo gjykata të japin një vendim përfundimtar. Gjykata vëren se dhe shkaku i pezullimit të kërkuesit nga detyra nuk ekziston më, pasi organi procedues ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të kërkuesit dhe se vendimi i Prokurorisë nuk është kundërshtuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Për pasojë, sipas VKM-së nr. 306, datë 13.6.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, pika 14, dhe nenit 22 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, rënia e shkaqeve të largimit dhe pezullimit nga detyra, presupozon rikthimin në punë të kërkuesit dhe të drejtën e pagës së plotë nga koha e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare.

34. Gjykata, gjithashtu, konstaton se Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pas vendimit të Prokurorisë, as nuk ka marrë ndonjë masë tjetër disiplinore ndaj kërkuesit dhe as nuk ka kundërshtuar urdhrin e ekzekutimit të Zyrës Përmbarimore Tiranë, me ndonjë prej mjeteve të mbrojtjes kundër ekzekutimit të vendimeve, të parashikuara në nenet 609 e vijues të KPC-së. Po ashtu, Gjykata vlerëson se thelbi i vendimit të KSHC-së ka qenë i qartë për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, pasi në përgjigjen drejtuar kërkuesit (shih shkresën prot. nr. 10634/2, datë 27.11.2007, të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave), shprehet se nuk mund të ekzekutojë vendimin e KSHC-së për mungesë vendesh të lira.

35. Për pasojë, nga sa më lart, Gjykata çmon se edhe titulli ekzekutiv i lëshuar nga Gjykata e Apelit është i qartë dhe, si i tillë, nuk ekziston asnjë arsye apo pengesë në ekzekutimin e tij nga ana e debitorit.

36. Për sa i përket sjelljes (veprimeve) së/të kërkuesit, nga tërësia e fakteve dhe rrethanave të çështjes, Gjykata çmon se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat e tij procedurale, duke shteruar mjetet ligjore në dispozicion të tij për rivendosjen e së drejtës së cenuar.

37. Lidhur me afatet kohore, Gjykata vëren se urdhri ekzekutiv, i lëshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, mban datën 13.11.2008. Kanë kaluar më shumë se katër vjet nga data që ka dalë ky urdhër dhe vendimi gjyqësor i formës së prerë ende nuk është zbatuar. Debitori (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave), ka pasur kohë të mjaftueshme në dispozicion për të ekzekutuar detyrimin ndaj kreditorit

(kërkuesit). Ai jo vetëm që nuk e ka bërë këtë, por nuk ka shfaqur deri tani vullnet dhe predispozitë si dhe vazhdon të shprehë hapur se nuk do të kryejë veprimet e duhura në plotësim të detyrimeve të tij ndaj kreditorit pavarësisht kohës që kalon, sepse ai nuk e konsideron vendimin për lëshimin e urdhrit ekzekutiv si titull ekzekutiv ose në rastin më të mirë e konsideron atë të paqartë. Gjykata vëren, gjithashtu, se edhe organi përgjegjës i ngarkuar me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë (Zyra e Përmbarimit Tiranë) nuk i ka marrë të gjitha masat përkatëse në drejtim të zbatimit efektiv të vendimit gjyqësor.

38. Si përfundim, në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata konstaton se ndodhet para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor të kërkuesit, të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit, nga autoritet e ngarkuara nga ligji dhe brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, si rrjedhojë e mosekzekutimit, brenda një afati të arsyeshëm, të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nr. 4894, datë 14.6.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Admir Thanza.

Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj.

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk jemi dakord me vendimin e shumicës për pranimin e kërkesës së paraqitur nga Feta Bundo, me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, ju paraqesim argumentet si vijon në mbështetje të qëndrimit tonë në pakicë.

2. Nga rrethanat e kësaj çështjeje ka rezultuar se ndaj kërkuesit, për shkelje të konstatuara gjatë kryerjes së detyrës, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Për këtë shkak, fillimisht, ndaj kërkuesit është marrë masa disiplinore e pezullimit nga detyra dhe, më pas, masa e largimit të tij nga detyra.

3. Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, Komisioni i Shërbimit Civil, me vendimin nr. 201, datë 30.9.2005, ka vendosur shfuqizimin e vendimit nr. 10251/9, datë 11.8.2005, për largimin nga shërbimi civil të kërkuesit, dhe shfuqizimin pjesërisht të aktit nr. 3623/5, datë 18.11.2004 në lidhje me shkakun dhe kohëzgjatjen e pezullimit nga detyra të kërkuesit, duke lënë në fuqi gjendjen e pezullimit deri në momentin kur prokuroria apo gjykata të japin një vendim përfundimtar. Ky vendim i KSHC-së është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe nga Gjykata e Lartë. Po ashtu, rezulton se pas përfundimit të hetimeve, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur pushimin e hetimeve në ngarkim të kërkuesit.

4. Kërkuesi Feta Bundo i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, me kërkesë për rikthimin e tij në punë. Pas përgjigjes së institucionit se nuk ka vende të lira pune, kërkuesi ka filluar procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm. Edhe pas këtyre procedurave, kërkuesi nuk ka mundur të

ekzekutojë vendimet gjyqësore dhe i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese me objekt konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

5. Në parashtrimet drejtuar kësaj Gjykate, subjekti i interesuar, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, ka pretenduar se kërkuesi Feta Bundo nuk ka shteruar mjetet ligjore për t`ju drejtuar kësaj Gjykate, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës. Sipas këtij subjekti, kërkuesi pas vendimit të Prokurorisë duhej të kërkonte gjyqësisht rivendosjen e të drejtave që kishte gëzuar para largimit nga shërbimi civil, pasi KSHC-ja ka vendosur pezullimin e vendimit të largimit nga detyra por nuk është shprehur lidhur me rikthimin e kërkuesit në vendim e mëparshëm të punës. Janë gjykatat e sistemit të zakonshëm që duhet të përcaktojnë saktësisht detyrimin e debitorit në mënyrë që ai të jetë i ekzekutueshëm.

6. Shumica në vendimin e saj, argumenton se ky pretendim është i pabazuar, pasi kërkuesi ka fituar të drejtën e rikthimit në punë si dhe të pagës së plotë nga koha e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare përderisa arsyeja e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nuk ekziston më, si dhe është shfuqizuar vendimi i largimit nga shërbimi civil. Pra, si përfundim, Gjykata ka vlerësuar se kërkuesi i ka shteruar të gjitha mjetet ligjore për t'iu drejtuar kësaj Gjykate. Ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se ky pretendim i subjektit të interesuar është i bazuar.

7. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të Kushtetutës dhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*shih vendimet nr. 6, datë 7.3.2011; nr. 35, datë 30.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar (*shih vendimet nr. 43, datë 19.12.2007; nr. 1, datë 19.1.2009; nr. 6, datë 6.3.2009; nr. 35, datë 30.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në kuptim të nenit 131, shkronja "f" të Kushtetutës, kërkuesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese. Sipas parashikimit të këtij neni, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Rregulli i vendosur nga dispozita e mësipërme kushtetuese e detyron kërkuesin, që për zgjidhjen e çështjes së tij, t'i drejtohet të gjitha instancave gjyqësore të zakonshme përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Kërkuesi legjitimohet vetëm kur shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor.

9. Siç rezulton nga materialet e kësaj çështjeje, kërkuesi kërkon ekzekutimin e vendimit nr. 201, datë 30.09.2005, të KSHC-së, i cili, në thelb, lë në fuqi gjendjen e pezullimit deri në momentin e dhënies së një vendimi përfundimtar lidhur me çështjen penale në ngarkim të kërkuesit. Ky vendim, edhe pse ka shfuqizuar vendimin për largimin e kërkuesit nga detyra, me arsyetimin e mësipërm, nuk është shprehur lidhur me pasojat e këtij vendimi, që lidhen me rikthimin e kërkuesit në detyrën e mëparshme dhe pagesën e pagës për këtë periudhë.

10. Pas përfundimit të hetimeve nga organi i prokurorisë dhe pushimit të çështjes penale në ngarkim të kërkuesit, ky i fundit i`u drejtua Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, në kuptim të nenit 22, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", për rikthimin e tij në detyrë. Për shkak se Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk ka pranuar të kthejë vullnetarisht kërkuesin në vendin e mëparshëm të punës, ai ka iniciuar procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm të vendimeve gjyqësore që kanë lënë në fuqi vendimin nr. 201, datë 30.09.2005, të KSHC-së. Në ndryshim nga sa ka arsyetuar shumica, vlerësojmë se vendimi i KSHC-së nuk ka gjykuar në themel mosmarrëveshjen midis kërkuesit dhe subjektit të interesuar, pasi nuk është shprehur për rikthimin kërkuesit në pozicionin e mëparshëm dhe as lidhur me pasojat financiare. Po ashtu, arsyetimi mbi të cilin është konstatuar shkelja e procedurave administrative, në procesin e vendimmarrjes për largimin e kërkuesit nga detyra, është bazuar në përmbajtjen e nenit 22, pika 2/a, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", sipas të cilit gjendja e pezullimit të marrëdhënieve të punës duhet të vazhdonte deri në momentin e

dhënies së një vendimi përfundimtar në lidhje me procedimin penal. Ne vlerësojmë se kërkuesi, me rënien e shkakut të pezullimit duhej ti drejtohej organit kompetent për të kërkuar rikthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës, si dhe kërkimet e tjera lidhur me sa më sipër.

11. Si përfundim, vlerësojmë se kërkuesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës dhe se ai nuk duhej të legjitimohej për t`ju drejtuar kësaj Gjykate.

Anëtare: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj

**VENDIM**
**Nr. 13, datë 16.4 2013**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Bashkim Dedja | Kryetar | i Gjykatës | Kushtetuese |
| Vladimir Kristo | Anëtar | i “ | “ |
| Xhezair Zaganjori | Anëtar | i “ | “ |
| Vitore Tusha | Anëtare | e “ | “ |
| Sokol Berberi | Anëtar | i “ | “ |
| Admir Thanza | Anëtar | i “ | “ |
| Altina Xhoxhaj | Anëtare | e “ | “ |
| Fatmir Hoxha | Anëtar | i “ | “ |

me sekretare Blerina Basha, në datën 7.2.2013 mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 46/19 Akti, që i përket:

KËRKUES: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshëm me Kushtetutën, i neneve 186 dhe 298 të Kodit Penal, në pjesën që parashikojnë dy dënime kryesore.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1, shkronja “d” dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Bashkim Dedja, shqyrtoi pretendimet e gjykatës referuese; prapësimet e subjektit të interesuar, Kuvendit, i cili ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe, pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

***Rrethanat e çështjes***

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjykata referuese) ka nisur gjykimin e çështjes penale me nr. 1056/112/20, që i përket të pandehurve: E.Rr., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit” të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal; H.B., akuzuar për kryerjen e veprës penale “Ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit” të kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal; M.V., akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal.

2. Me vendimin nr. 1056, datë 3.10.2012, pasi ishin dhënë dhe konkluzionet përfundimtare nga palët, gjykata referuese ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes me të pandehurit E.Rr., H.B., M.V., dhe dërgimin e çështjes Gjykatës Kushtetuese (Gjykatës).

3. Gjykata referuese i kërkon Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë papajtueshmërinë me Kushtetutën të dy neneve, përkatësisht 186 dhe 298 të Kodit Penal (KP), ku parashikohet:

Neni 186 (ndryshuar me ligjin nr.9188/2004; shtuar me ligjin nr. 10023/2008)

Falsifikimi i dokumenteve

*1. Falsifikimi ose përdorimi i dokumenteve të falsifikuara dënohet me burgim deri në tre vjet dhe me gjobë nga dyqind mijë deri në gjashtëqind mijë lekë.*

*2. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në katër vjet dhe me gjobë nga treqind mijë deri në një milion lekë.*

*3. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me burgim nga një vit deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga pesëqind mijë deri në dy milionë lekë.*

Neni 298 (shtuar me ligjin nr. 8733/2001, ndryshuar me ligjet nr. 9188, datë 12.2.2004 dhe nr. 9686, datë 26.2.2007)

Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit

*1. Strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të lundrimit, të fluturimit apo i mjeteve të tjera të transportit, apo çdo ndihmë tjetër me qëllim kalimin e paligjshëm të kufirit të Republikës së Shqipërisë, ose për hyrjen e paligjshme të një personi në një shtet tjetër pa qenë shtetas i tij, ose që nuk ka leje qëndrimi në atë shtet, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në katër vjet dhe me gjobë nga tre milionë deri në gjashtë milionë lekë.*

*2. Kur ndihma jepet për qëllime fitimi, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga katër milionë deri në tetë milionë lekë.*

*3. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtë milionë deri në tetë milionë lekë.*

*4. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm, si dhe me gjobë nga tetë milionë deri në dhjetë milionë lekë.*

*5. Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim dhe gjoba shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.*

4. Gjatë shqyrtimit paraprak, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, më datë 02.11.2012, vendosi kalimin në seancë plenare të çështjes dhe shqyrtimin e saj mbi bazë dokumentesh.

II

***Vlerësimet e palëve***

5. ***Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë*** ka vënë në dyshim kushtetutshmërinë e dy dispozitave të sipërcituara, duke parashtruar argumentin se me vendimin nr. 47, datë 26.07.2012, Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar nenin 29/3 të Kodit Penal, ku parashikoheshin dy dënime kryesore për veprat penale, me burg dhe me gjobë, pasi ishte në kundërshtim me nenin 17/1 të Kushtetutës. Po me këtë vendim, Gjykata ka shfuqizuar në nenet 190 dhe 191 të Kodit Penal, dënimin me gjobë, duke lënë në fuqi vetëm dënimin me burgim si dënim kryesor në lidhje me parashikimin e veprave penale në këto nene. Me këtë vendim, Gjykata është shprehur se ajo e shqyrton proporcionalitetin e një kufizimi rast pas rasti, duke pasur parasysh disa aspekte, si balancën mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë ligjvënësi. Në këto kushte, sipas gjykatës referuese, nenet 186 dhe 298 të Kodit Penal duhet të vlerësohen nga Gjykata, në lidhje me respektimin e parimit të proporcionalitetit, dhe kjo gjykatë duhet të saktësojë se cili nga dy dënimet, me burg apo me gjobë, do të zbatohet për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve si dhe ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit.

6. Gjykata referuese vlerëson se ndodhet në pamundësi të gjykimit të çështjes konkrete, pa u shprehur Gjykata Kushtetuese mbi kushtetutshmërinë e neneve dhe përcaktimin e aplikimit të njërit nga dy sanksionet kryesore për veprat penale, për të cilat janë akuzuar të pandehurit.

7. ***Kuvendi***, si palë e interesuar, ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar këto argumente:

7.1 Gjykata referuese nuk legjitimohet, sepse ka arritur të zhvillojë tërë procesin gjyqësor, dhe, pasi i ka dhënë fund shqyrtimit gjyqësor, ka dalë me vendim pezullimi për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, ndërkohë që duhet të ndodhte e kundërta, pra që në fillim të shqyrtimit të çështjes, ajo duhet të kishte krijuar bindjen për antikushtetutshmërinë e dispozitave dhe të pezullonte çështjen.

7.2 Gjykata referuese nuk legjitimohet sepse, në vendimin e pezullimit, nuk ka parashtruar shkaqe dhe argumente për antikushtetutshmërinë e dispozitave përkatëse, por është mjaftuar vetëm me referimin tek vendimi nr. 47, datë 26.7.2012 i Gjykatës Kushtetuese, si shkak pezullimi.

7.3 Kufizimi i vendosur tek nenet 186 dhe 298 të KP-së është konform standardeve të nenit 17 të Kushtetutës. Ai është diktuar nga një interes publik, që është lufta kundër krimit të organizuar, siguria e rendit publik dhe shoqëror si dhe rritja e efektivitetit të masave shtrënguese ndaj autorëve të veprave penale. Në përcaktimin e dy dënimeve kryesore për veprën penale të ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit, qëllimi i ligjvënësit ka qenë rëndësia e madhe e kësaj vepre penale.

7.4. Ligjvënësi ka hapësirë të gjerë veprimi në përcaktimin e veprave penale dhe të llojit të dënimit me qëllim mbrojtjen e pavarësisë së shtetit, dinjitetit të njeriut, rendit kushtetues. Ligjvënësi është përgjegjës për hartimin e politikave penale. Dispozitat dhe fryma e KP-së janë udhëhequr nga parashikimet e disa prej kodeve më të zhvilluara në këtë fushë, si ai francez dhe italian, të cilët parashikojnë dy dënime: - me burgim - dhe / ose gjobë. Për falsifikimin e dokumenteve edhe Kodi Penal francez parashikon dënimin me burg si dhe dënimin me gjobë (neni 441-2; 441-3).

8. ***Këshilli i Ministrave,*** si palë e interesuar, nuk ka paraqitur parashtrime në lidhje me çështjen.

III

***Vlerësimi i Gjykatës***

9. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në përputhje me nenet 134/1/d dhe 145/2 të Kushtetutës mund të ushtrojnë kontrollin e kushtetutshmërisë së normës gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore, kur plotësohen disa kushte: së pari, gjykata referuese duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); së dyti, ajo duhet të parashtrojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij duke u referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; së treti, duhet të ekzistojë raporti i domosdoshëm midis vendimit të Gjykatës Kushtetuese (zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë) dhe zgjidhjes së çështjes konkrete nga gjykata referuese; së katërti, para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimet nr. 13, datë 4.5.2009; nr. 2, datë 3.2.2010; nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata referuese, bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 47, datë 26.7.2012, ka ngritur dyshime lidhur me pajtueshmërinë me Kushtetutën të neneve 186 dhe 298 të KP-së, të cilat parashikojnë dy dënime kryesore, dhe i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për gjykim incidental.

11. Në vendimin nr. 47, datë 26.7.2012, Gjykata, pasi ka konstatuar se është plotësimi që iu bë nenit 29 të KP-së nga ligjvënësi me ligjin nr. 9086, datë 19.06.2003, lidhur me parashikimin njëkohësisht të dënimit me burgim dhe atij me gjobë, që ka shërbyer si bazë ligjore për të gjitha ndryshimet e ndërmarra më vonë në Pjesën e Posaçme të Kodit Penal për parashikimin e dy dënimeve kryesore në vepra të ndryshme penale, e ka shfuqizuar atë për shkak se vjen në kundërshtim me nenin 17/1 të Kushtetutës. Sipas vlerësimit të Gjykatës, përcaktimi paraprakisht nga ligjvënësi i dënimit me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burg, në një sërë dispozitash penale, ndërhyn në atributet ekskluzive të gjykatës lidhur me caktimin në rastin konkret të dënimit.

12. Në vendimin e saj nr. 47, datë 26.7.2012, Gjykata, gjithashtu, ka arsyetuar se secili prej dënimeve kryesore, të parashikuara nga neni 29 i KP-së, të zbatuara kur është nevoja së bashku me dënimet plotësuese si dhe me dënimin me gjobë sipas parashikimit të nenit 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë të KP-së, është i mjaftueshëm në arritjen e qëllimit të dënimit penal dhe në proporcion me

parimet e legjislacionit penal, duke respektuar njëkohësisht parimin e ndarjes së pushteteve. Për pasojë, parashikimi *a priori* i dy dënimeve kryesore nuk është proporcional si dhe bie ndesh me parimin e individualizimit të dënimit e, si rrjedhojë, me parimin e dhënies së drejtësisë nga ana e gjykatës, pasi i heq kësaj të fundit mundësinë e përcaktimit, rast pas rasti, të dënimit penal sipas rrethanave të çështjes konkrete në shqyrtim.

13. Pas deklarimit nga kjo Gjykatë të antikushtetutshmërisë së nenit 29, paragrafi i fundit, të KP-së, ajo (Gjykata) thekson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, gjatë shqyrtimit konkret të veprave penale, nuk mund të aplikojnë njëkohësisht dy dënime kryesore, në rastet kur këto dënime janë të parashikuara në dispozitat e Pjesës së Posaçme të KP-së. Në këto raste, gjykatat duhet të aplikojnë vetëm dënimin me burgim dhe, nëse plotësohen kushtet e sanksionuara në nenin 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë, të KP-së, gjykata në bazë të vlerësimit konkret të rrethanave të çështjes, mund të aplikojë krahas dënimit me burgim edhe dënimin me gjobë, kur vepra penale passjell përfitime materiale për autorin e saj. Gjykata, po ashtu, thekson se neni 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë, i KP-së aplikohet si në rastet kur dispozitat e KP-së përcaktojnë si dënim për veprën penale vetëm atë me burgim, ashtu dhe në rastet kur ato (dispozitat) sanksionojnë njëkohësisht dy dënime kryesore.

14. Në rastin objekt shqyrtimi, gjykata referuese, për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve dhe ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit, të sanksionuara në nenet 186 dhe 298 të KP-së, në interpretim të vendimit nr. 47, datë 26.7.2012 të Gjykatës, duhet të zbatojë vetëm dënimin me burgim si dënim kryesor dhe, sipas diskrecionit të saj, nëse plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë, të KP-së, edhe dënimin me gjobë. Për rrjedhojë, nuk qëndron pretendimi i gjykatës referuese se pa u shqyrtuar më parë kushtetutshmëria e neneve 186 dhe 298 të KP-së, ajo nuk mund të zgjidhë çështjen konkrete.

15. Si përfundim, Gjykata vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë të gjitha mundësitë me parashikimet aktuale të KP-së të japin dënimin me burgim si dënim kryesor, në të gjitha rastet e përcaktimit të dy dënimeve kryesore  në dispozitat e Pjesës së Posaçme të KP-së, si dhe ta ashpërsojnë atë me dënimin më gjobë kur plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë, të KP-së.

16. Për sa më sipër, Gjykata çmon se gjykata referuese jo vetëm nuk plotëson kushtin e ekzistencës së një raporti të domosdoshëm midis zgjidhjes së çështjes së kushtetutshmërisë dhe zgjidhjes së çështjes konkrete, por ajo, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, nuk ka bërë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar dispozitën e kundërshtuar në frymën e interpretimit të vendimit nr. 47, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese. Për pasojë, kërkuesi nuk legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 186 dhe 298 të Kodit Penal, në pjesën që parashikojnë dy dënime kryesore.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës[1].

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj

[1] Gjyqtarët V. Tusha, A. Xhoxhaj dhe S.Berberi votuan  për rrëzimin, por me argumente të tjera.

MENDIM PARALEL

Në çështjen konkrete pajtohemi me vendimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, por kemi mendim të ndryshëm në lidhje me arsyet për këtë qëndrim, ndaj e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim paralel.

Gjykata referuese, bazuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 47, datë 26.7.2012 (nr. 47/2012), ka ngritur dyshime lidhur me pajtueshmërinë me Kushtetutën të neneve 186 dhe 298 të KP-së, të cilat parashikojnë dy dënime kryesore, dhe i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për gjykim incidental.

Shumica nuk e ka legjitimuar gjykatën referuese për këtë pretendim, duke ritheksuar edhe një herë interpretimin që gjykatat duhet t'i bëjnë vendimit nr. 47/2012, ku trajtohet një pretendim i ngjashëm, dhe duke arsyetuar se mbi bazën e këtij interpretimi dhe parashikimeve aktuale të KP-së, gjykata referuese mund ta zgjidhte çështjen konkrete. Sipas saj, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, për shkak të antikushtetutshmërisë së nenit 29, paragrafi i fundit i KP-së, nuk mund të aplikojnë njëkohësisht dy dënime kryesore në rastet kur këto dënime janë të parashikuara në dispozitat e Pjesës së Posaçme të KP-së. Këto gjykata, në këto raste, duhet të zbatojnë vetëm dënimin me burgim, si dënim kryesor dhe, në bazë të vlerësimit konkret të rrethanave të çështjes, mund të aplikojnë krahas dënimit me burgim edhe dënimin me gjobë, kur plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë i KP-së (*paragrafi 15 i vendimit)*. Ne, në dallim nga shumica, vlerësojmë se gjykata referuese legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas objektit të kërkesës, por kërkesa duhej të rrëzohej për arsye se pretendimet për jokushtetutshmërinë e neneve 186 dhe 298 të KP-së, janë të pabazuara.

Ne gjykojmë se vendimi nr. 47/2012 i kësaj Gjykate, në lidhje me kushtetutshmërinë e pjesëve të dispozitave penale të posaçme, ku parashikohet dënimi me gjobë krahas atij me burgim, ka krijuar paqartësi tek gjykatat e zakonshme, kur këto duhet të aplikojnë dënimin në raste konkrete, që rregullohen nga këto dispozita penale të posaçme. Kjo paqartësi reflektohet pikërisht në paraqitjen e kësaj kërkese nga gjykata referuese, duke pasur parasysh fuqinë detyruese të përgjithshme të vendimeve të Gjykatës.

Gjykata ka theksuar se është në diskrecionin e ligjvënësit vlerësimi i mjetit të zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe qëllimit që kërkohet të arrihet por, kur është fjala për parashikimin e dispozitave penale dhe sanksioneve përkatëse si *"ultima ratio",* ligjvënësi duhet të udhëhiqet nga parimet kushtetuese dhe funksionet që karakterizojnë dënimet penale. Gjykata vlerëson proporcionalitetin e masave penale në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat ato jepen. Ajo ka theksuar se proporcionalitetin e një kufizimi ajo e vlerëson rast pas rasti dhe duke pasur parasysh disa aspekte, si balancën mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë ligjvënësi, aspekte që nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën. Vendosja me ligj e llojit të dënimeve është përgjithësisht diskrecion i pushtetit legjislativ, i cili, në përputhje me kërkesat dhe me nevojat në ndryshim të shoqërisë, bën rregullimin ligjor përkatës, por Gjykata analizon proporcionalitetin e kësaj mase në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre (*shih vendimin nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Siç jemi shprehur me mendimin në pakicë në vendimin nr. 47/2012, karakteri i drejtë ose jo i një dënimi nuk lidhet me numrin e efekteve të drejtpërdrejta apo anësore që ai mbart në vetvete, por me përputhjen e tij me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit të saj dhe se parimi i drejtësisë së dënimit nuk lidhet në korrelacion kaq të drejtpërdrejtë mes llojit të dënimit dhe veprës penale, por me sigurimin, brenda respektimit të dinjitetit njerëzor, të një baraspeshimi mes rëndësisë së masës ndëshkuese dhe rëndësisë së veprës penale. Neni 29 i KP-së nuk gjen zbatim *a priori* për çdo vepër penale, por ai gjen zbatim rast pas rasti, sipas parashikimeve specifike në dispozitat përkatëse të KP-së që rregullojnë veprat e ndryshme penale. Vlerësimi nëse një dënim i caktuar penal, për shkak të kufizimit që përcakton në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është proporcional në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e atij dënimi, është një vlerësim që duhet bërë rast pas rasti, pas shqyrtimit të rrethanave konkrete të çështjes kushtetuese dhe pas marrjes

në analizë të elementeve të veprës penale përkatëse, shkallës së rrezikshmërisë dhe pasojave që vijnë nga ajo vepër penale.

Shumica, në arsyetimin e vendimit, nuk ka arritur të japë argumente që lidhen me mosplotësimin e kushtit të diktuar nga norma kushtetuese, i cili kërkon që masat e marra të jenë proporcionale në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre.

Në këtë drejtim shumica ka çmuar se përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve është në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila, duke shqyrtuar gjithë elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale. Duke pasur parasysh sa më sipër, duket se shumica nuk argumenton cenimin e kritereve kushtetuese për kufizimin e së drejtës, por, në thelb, i referohet parimit të ndarjes së pushteteve, pa analizuar se si cenohet ky parim në rastin në shqyrtim. Ndryshe nga sa argumenton shumica, gjykata nuk pengohet në rastin konkret për sa i përket individualizimit të dënimit për veprat penale të parashikuara nga nenet 186 dhe 298 të KP-së, përkundrazi, ajo ka një fushëveprimi të gjerë për caktimin e llojit dhe masës së dënimit në përputhje me dispozitat penale të sipërpërmendura.

Për më tepër, shumica nuk ka argumentuar arsyet kushtetuese për sa i përket orientimit që i jep gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, sipas të cilit, në rastet e përmendura më sipër, ato të aplikojnë vetëm dënimin me burgim, dhe, nëse plotësohen kriteret e parashikuara nga neni 34, paragrafi i pestë e i gjashtë i KP-së, edhe dënimin me gjobë. Përcaktimi i llojit të sanksionit duhet të bëhet nga ligjvënësi pozitiv. Kuvendi ka një hapësirë të gjerë vlerësimi për formulimin e sanksionit duke përcaktuar, krahas veprave penale edhe llojin e masën e dënimit, në proporcion me rrezikshmërinë e veprës. Kjo i jep mundësinë gjyqtarit të japë një gjykim të drejtë dhe të caktojë një masë dënimi brenda kufijve të përcaktuar nga legjislacioni penal, duke e individualizuar dënimin brenda kësaj fushëveprimi.

Për sa më sipër, kërkesa e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me jokushtetutshmërinë e neneve 186 dhe 298 të KP-së, të cilat parashikojnë dy dënime kryesore, është e pabazuar, dhe, për rrjedhojë, duhej rrëzuar me këtë argument.

Anëtarë: Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Sokol Berberi

**VENDIM**
**Nr. 14, datë 17.4.2013**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Bashkim Dedja | Kryetar | i Gjykatës | Kushtetuese |
| Vladimir Kristo | Anëtar | i “ | “ |
| Xhezair Zaganjori | Anëtar | i “ | “ |
| Vitore Tusha | Anëtare | e “ | “ |
| Sokol Berberi | Anëtar | i “ | “ |
| Admir Thanza | Anëtar | i “ | “ |
| Altina Xhoxhaj | Anëtare | e “ | “ |
| Fatmir Hoxha | Anëtar | i “ | “ |

me sekretare Blerina Basha, në datën 20.11.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 39/13 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, përfaqësuar nga Presidenti, Dr. Av. Sinan Tafaj.

Avokati i Popullit

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga znj. Arjeta Çefa.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga znj. Marsida Xhaferllari.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr. 26, datë 5.4.2012 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8098, datë 28.3.1996 'Për statusin e të verbrit'";

Pezullimi i zbatimit të ligjit nr. 26, datë 5.4.2012.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 18, 52, 59/f, 116/1, 124, 131/a, 132 dhe 134/1/f dhe të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1/2, 2, 27, 28, 29, 30, 39, 45, 49, 50, 51 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë"; neni 24/c i ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuesve, Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë dhe Avokatit të Popullit, të cilët kërkuan pranimin e kërkesës; prapësimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (Kuvendi) dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave), të cilët kërkuan rrëzimin e kërkesës dhe, pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Në datën 15.3.1996 është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë ligji nr. 8098 "Për statusin e të verbrit", i cili, me qëllim integrimin e personave të verbër në jetën normale, u ka njohur atyre një status të veçantë si dhe një sërë të drejtash dhe përfitimesh për shkak të paaftësive të tyre fizike.

2. Neni 11 i ligjit të lartpërmendur parashikonte: "*Të verbrit kanë të drejtë që ata vetë dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë falas në transportin urban, dhe me gjysmë çmimi në transportin interurban, duke përfshirë atë shtetëror dhe privat"*; ndërsa në lidhje me tarifat telefonike dhe ato të energjisë elektrike, neni 12 i ligjit për statusin e të verbrit parashikonte: "*Të gjithë të verbrit, të paaftë për të lëvizur pa shoqërues, në kushte fizike të invaliditetit të grupit të parë, pajisen me telefon. Ata paguajnë tarifë telefonike të nivelit të parë të favorizuar për popullsinë, e përcaktuar në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duke u përjashtuar nga tarifat e tjera, diferencat paguhen nga shteti. Të gjithë personat e verbër, sipas nenit 1 të këtij ligji, paguajnë 20 për qind të vlerës së konsumit mujor të energjisë elektrike, diferencat paguhen nga shteti*".

3. Kuvendi i Shqipërisë, me ligjin nr.26, datë 5.4.2012, ka miratuar disa ndryshime në ligjin nr.8098, "Për statusin e të verbrit". Si pasojë e këtyre ndryshimeve, dispozitat e lartpërmendura tashmë sanksionojnë:

Neni 11: "*Të verbrit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave"*.

Neni 12: *"Të gjithë personat e verbër, sipas nenit 1 të këtij ligji, përfitojnë kompensim të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës telefonike fikse. Masa, kriteret dhe procedurat e përfitimit të këtij kompensimi financiar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave*".

4. Në zbatim të ligjit nr.26, datë 5.4.2012, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr.404, datë 20.06.2012 "*Për përcaktimin e masës së kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik, për faturën e energjisë elektrike dhe faturën e telefonisë fikse*", i cili parashikon:

Neni 2: "*Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, që kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 2 000 (dy mijë) lekë në muaj*".

Neni 3: *"(...) individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të cilët nuk kanë nevojë për kujdestarë, u jepet një kompensim për faturën e energjisë elektrike, në masën 1 400 (një mijë e katërqind) lekë në muaj*".

Neni 5: "*Individëve përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbrit", të ndryshuar, të cilët kanë nevojë për kujdestarë, u jepet kompensim për faturën e telefonisë fikse, në masën 1 000 (një mijë) lekë në muaj"*.

Neni 7: "*Përfituesit, objekti i këtij vendimi, përjashtohen nga kompensimi i çmimit të energjisë elektrike, të parashikuar në vendimin nr. 565, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga rritja e çmimit të energjisë elektrike*".

5. Masa e kompensimit për shërbimin e transportit urban dhe interurban në favor të personave invalidë në fjalë nuk është përcaktuar akoma nga Këshilli i Ministrave.

II

6. ***Kërkuesit, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë*** **dhe** ***Avokati i Popullit*****,** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), për shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr.26, datë 5.4.2012, si dhe pezullimin e zbatimit të këtij ligji, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se:

6.1 Mënyra e re e llogaritjes së kompensimit të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës telefonike fikse për personat e verbër, sipas ligjit të kundërshtuar dhe sipas aktit nënligjor të miratuar në zbatim të tij, kanë sjellë humbje të të drejtave dhe standardit të fituar duke çuar në përkeqësimin e jetesës së këtyre personave. Ndërsa mosparashikimi i kritereve dhe procedurave për kompensim për shërbimin e transportit për këta persona invalidë, krijon jo vetëm pasiguri dhe pamundësi për të realizuar të drejtat e fituara, por edhe privim nga një e drejtë themelore, ajo e lëvizjes. Në këtë mënyrë është cenuar parimi i sigurisë juridike.

6.2 Ligji i kundërshtuar ka cenuar parimin kushtetues të zbatimit të drejtpërdrejtë të normave kushtetuese, në referim të nenit 4/2 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në referim edhe të nenit 59, shkronja "f" të Kushtetutës, është cenuar përmbushja e objektivit social të shtetit për përmirësimin e jetës së personave me aftësi të kufizuar dhe integrimin e tyre shoqëror.

6.3 Përcaktimi i masës së përfitimit të kompensimit të të drejtave në fjalë, të cilat bëjnë pjesë në grupin e të drejtave ekonomike-sociale dhe që lidhen thelbësisht me të drejtat themelore të njeriut, me VKM dhe jo me ligj, përbën kufizim të tyre. Ky kufizim është bërë në kundërshtim me nenin 52/2 të Kushtetutës, që sanksionon se ndihmat ekonomike për kompensimin e rrethanave të caktuara, të krijuara për shkaqe të pavarura nga vullneti i individit, duhet të parashikohen me ligj. Gjithashtu, kufizimi i këtyre të drejtave është bërë në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, pasi nuk justifikohet nga interesi publik apo gjendja e veçantë.

6.4 Është cenuar parimi i barazisë. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.404, datë 20.6.2012, për kompensimin e energjisë elektrike dhe faturës së telefonisë fikse si kriter për diferencim ka përdorur nivelin e aftësisë së kufizuar (nevoja apo jo për kujdestar), dhe jo gjendjen ekonomike të personave invalidë në fjalë, duke përcaktuar vlera fikse për grupe të ndryshme. Në këtë mënyrë subvencionimi ka passjellë edhe diskriminimin e tyre.

***7. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë,*** pretendon rrëzimin e kërkesës, duke prapësuar si më poshtë:

7.1 *Në lidhje me legjitimimin e kërkuesit, Avokatit të Popullit:*

7.1.a. Në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës dhe nenit 49 të ligjit 8577, datë 2.10.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", kërkuesi, Avokati i Popullit, nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, pasi nuk plotëson kriterin e interesit për të vepruar. Sipas subjektit të interesuar, Avokati i Popullit, mund t'i drejtohet kësaj Gjykate kur janë cenuar të drejtat, liritë apo interesat e ligjshme të individit nga veprime apo mosveprime të paligjshme të organeve të administratës publike. Në rastin objekt shqyrtimi, ligji i kundërshtuar nuk është akt i administratës publike dhe, për më tepër, kërkuesi nuk ka argumentuar se ka përdorur instrumentet ligjore për marrjen e masave për eliminimin e shkeljeve të pretenduara.

7.2 *Në lidhje me themelin e kërkesës:*

7.2.a. Të drejtat e parashikuara në ligjin objekt kundërshtimi janë objektiva socialë tek të cilët shteti synon brenda kompetencave dhe mjeteve që disponon. Si të tilla, ato nuk mund të cilësohen si të drejta të fituara apo të drejta themelore.

7.2.b. Nuk është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi, sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, parimi i sigurisë juridike bashkëvepron edhe me parime të tjera si ai i shtetit social, i cili i siguron ligjvënësit një hapësirë të gjerë dhe të papërcaktueshme saktësisht për të rregulluar përfitimin e të

mirave sociale në një masë dhe sasi të caktuar. Në rastin në shqyrtim, kemi të bëjmë me programe dhe objektiva socialë, që për nga natyra nuk mund të jenë të përhershëm dhe të pandryshueshëm.

7.2.c. Ligji garanton të drejtën e subjekteve që përfitojnë kompensim për shërbimet e transportit, energjisë elektrike dhe telefonisë fikse. Delegimi i përcaktimit të kritereve të përfitimit Këshillit të Ministrave, pas privatizimit të shërbimeve të shpërndarjes elektrike dhe të telefonisë, ka për qëllim përmirësimin e administrimit të skemës së kompensimit për të shmangur abuzimet e mundshme. Për këtë arsye, ligji nuk sjell diskriminim të personave të verbër.

7.2.d. Legjislacioni shqiptar, në përmbushje të nenit 52/2 të Kushtetutës, rregullon me një sërë ligjesh të drejtën e ndihmës së personit të mbetur pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese. Për këtë arsye, referenca që bëjnë kërkuesit tek neni 52/2 i Kushtetutës është e gabuar.

8. ***Subjekti i interesuar****, Këshilli i Ministrave,* duke e konsideruar kërkesën të pabazuar, parashtroi:

8.1. *Në lidhje me legjitimimin e kërkuesit, Avokatit të Popullit:*

8.1.a. Kërkuesi nuk legjitimohet t'i drejtohet kësaj Gjykate pasi në kërkesën e tij ai nuk specifikon shkeljet konkrete dhe argumentet që do të justifikonin interesin për të iniciuar kontrollin kushtetues të ligjit, në bazë të nenit 134/2 të Kushtetutës. Në këtë drejtim, në çështjen që kërkon të shqyrtohet, Avokati i Popullit nuk ka arritur të provojë nëse të drejtat që sanksionohen nga ligji i kundërshtuar kanë qenë objekt i veprimtarisë konkrete të tij.

8.2. *Në lidhje me themelin e kërkesës:*

8.2.a. Të drejtat e përfituara nga personat që gëzojnë statusin e të verbrit, në lidhje me transportin, kompensimin e pagesave të energjisë dhe telefonisë fikse, janë pagesa sociale me qëllim riintegrimin e tyre në jetën shoqërore. Ato kanë karakter personal dhe masa e tyre përballohet nga buxheti i shtetit. Këto përfitime apo kompensime janë shtesa për shkak të invaliditetit të personave të verbër dhe është në tagrin e Këshillit të Ministrave të disponojë me vendim masën, kriteret dhe procedurën e kësaj pagese shtesë.

8.2.b. Të drejtat e parashikuara në ligjin objekt kundërshtimi u përkasin të drejtave me natyrë sociale dhe si të tilla nuk mund të cilësohen si të drejta themelore të njeriut. Sikurse është shprehur edhe Gjykata Kushtetuese (*shih vendimet nr.34, datë 28.5.2012 dhe nr.37, datë 13.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*), ato hyjnë në grupin e lirive pozitive, plotësimi i të cilave nuk kërkon vetëm angazhimin e autoriteteve shtetërore, por kërkon edhe mjete e burime financiare pasi e drejta e përfitimit të shtesës/kompensimit është vetëm një nga të drejtat me karakter social dhe ekonomik që përfitojnë personat me aftësi të kufizuar. Po në këtë drejtim, sipas nenit 59/1 të Kushtetutës, realizimi i objektivave socialë bëhet në masën dhe brenda mjeteve që shteti disponon dhe përmbushja e tyre nuk mund të kërkohet drejtpërdrejt në gjykatë (paragrafi i dytë).

8.2.c. Nevojat dhe raportet shoqërore në shtetin demokratiko-kushtetues janë relative, të këmbyeshme në varësi të zhvillimeve të brendshme, dukurive rajonale dhe atyre globale. Në varësi të këtyre të fundit krijohen raporte dhe ekuilibra të rinj shoqërorë, që kërkojnë një rregullim të ri ligjor apo nënligjor për të plotësuar nevojat dhe kërkesat sociale të vendit. Parashikimi dhe mbajtja e skemave të ngurta sociale, apo të pandryshueshme, do të krijonte situata avantazhi apo disavantazhi për grupet e ndryshme sociale të shoqërive. Në këto kushte, ndryshimet e reja ligjore parashikojnë pikërisht zbatimin e skemave fleksibël dhe i përgjigjen interesave publike. Për këto arsye, ligji objekt kundërshtimi nuk cenon parimin e sigurisë juridike. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj.

8.2.d. Përcaktimi i një skeme të re procedurale që përfshin kriteret, masën dhe hapat e procedurës për përfitimin e të drejtave që njeh ligji, nuk do të thotë që këto të drejta iu janë mohuar personave me aftësi të kufizuar, pasi ndryshimet nuk vënë në diskutim ekzistencën e të drejtës për pagesë.

III

***Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese***

***A. Lidhur me pezullimin e zbatimit të ligjit***

9. Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e zbatimit të ligjit nr.26, datë 5.4.2012, deri në dhënien e një vendimi përfundimtar prej saj. Në kuptim të nenit 45 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", Mbledhja e Gjyqtarëve vendosi rrëzimin e kërkesës për pezullim, për arsye se nuk gjeti argumente bindëse për cenimin e interesave të personave të verbër, si rrjedhojë e zbatimit të menjëhershëm të ligjit të lartpërmendur.

***B. Lidhur me legjitimimin e kërkuesve***

10. Subjektet e interesuara kanë ngritur pretendimin se Avokati i Popullit nuk legjitimohet për t'iu drejtuar kësaj Gjykate, duke pretenduar, në thelb, mungesën e interesit të tij në këtë çështje dhe mosparaqitjen e shkeljeve konkrete në kërkesë.

11. Gjykata vëren se e drejta e Avokatit të Popullit për ta vënë atë në lëvizje ka tashmë një trajtim të qëndrueshëm në jurisprudencën kushtetuese. Avokati i Popullit, si një nga subjektet që mund të iniciojë procesin e kontrollit kushtetues, në bazë të nenit 134/2 të Kushtetutës, duhet të justifikojë interesin e tij në çështjen konkrete dhe që lidhet me ushtrimin e funksionit të tij kushtetues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme ose të parregullta të organeve të administratës publike. Kur gjatë shqyrtimit të ankesave, kërkesave ose njoftimeve që i paraqiten, Avokati i Popullit evidenton shkelje, nga ato të sipërcituara, rekomandon, nëse është e nevojshme, marrjen e masave me karakter normativ. Krahas kësaj, një mënyrë tjetër, me të cilën ky organ realizon funksionin e tij në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, është dhe vënia në lëvizje e Gjykatës për shfuqizimin e akteve normative, të nxjerra nga organet e administratës publike dhe që rezultojnë të jenë në papajtueshmëri me Kushtetutën. Në raste të tilla, Avokati i Popullit duhet të argumentojë shkeljen konkrete dhe interesin në çështjen që kërkon të shqyrtohet *(shih vendimet nr.40, datë 16.11.2007; nr. 33, datë 24.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata konstaton, gjithashtu, se interesi i Avokatit të Popullit në kuptim të nenit 134/2 të Kushtetutës, duhet të shqyrtohet rast pas rasti. Gjykata është shprehur dhe më parë në praktikën e saj, se interesi konsiston tek e drejta e shkelur, tek dëmi real apo potencial dhe jo tek premisat teorike mbi antikushtetutshmërinë e normës që ka sjellë këtë cenim të interesit dhe se ky interes duhet të jetë i sigurt, i drejtpërdrejtë dhe vetjak *(shih vendimet nr.31, datë 18.06.2010 ; nr.4, datë 23.02.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

13. Në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata vlerëson se kërkesa lidhet me përmbajtjen e ligjit, i cili, sipas Avokatit të Popullit, duke përcaktuar skemën e re për llogaritjen e mënyrës së kompensimit të energjisë elektrike, telefonisë fikse dhe shërbimit të transportit, sjell pasoja direkte në të drejtat për ndihmë ekonomike, si të drejta ekonomike-sociale, të fituara nga personat e verbër. Gjithashtu, cenimi është aktual dhe jo potencial, pasi, sipas kërkuesit, personat e lartpërmendur janë penguar realisht të ushtrojnë si më parë këto të drejta për ndihmë ekonomike, si rrjedhim i përmbajtjes së dispozitës së ligjit të kundërshtuar dhe VKM-së nr.404, datë 20.6.2012. Edhe elementi i tretë, pra lidhja e drejtpërdrejtë me subjektin, ekziston, pasi është në funksionin e Avokatit të Popullit të mbrojë interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të administratës publike. Kërkuesi ka parashtruar se ai është vënë në lëvizje për këtë shkelje nga vetë personat me aftësi të kufizuar, të cilëve u është ndërprerë subvencionimi i faturave të energjisë elektrike dhe nuk gëzojnë më kompensimin e mëparshëm për shërbimin e transportit urban dhe interurban. Avokati i Popullit, në ushtrim të kompetencave të veta, ka krijuar mendimin se shkak për këtë situatë është përmbajtja e dispozitave të ligjit të kundërshtuar dhe të VKM-së së miratuar në zbatim të tij, eliminimi i të cilave mund të sjellë si pasojë vendosjen në vend të të drejtave të shkelura. Në këto rrethana, Gjykata çmon se vënia e saj në lëvizje nga Avokati i Popullit është në përputhje me funksionin e tij kushtetues dhe me filozofinë e krijimit të këtij institucioni, si një mekanizëm efektiv në mbrojtje të të drejtave dhe lirive kushtetuese të shtetasve, të drejta të cilat përbëjnë bazën e rendit tonë juridik. Për pasojë, pretendimi i subjekteve të interesuara, në lidhje me legjitimimin e Avokatit të Popullit, nuk është i bazuar.

14. Ndërsa, për sa i përket legjitimimit të kërkuesit tjetër, Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë, Gjykata ka tashmë një jurisprudencë të konsoliduar, e cila ka pranuar legjitimimin e këtyre subjekteve për çështje që lidhen me interesat e tyre (*shih vendimet nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 43, datë 6.10.2011; nr.34, datë 28.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

***C. Lidhur me themelin e kërkesës***

***C.1. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike***

15. Kërkuesit kanë pretenduar se parashikimet e ligjit që kundërshtohet dhe të VKM-së së miratuar në zbatim të tij, kanë cenuar parimin i sigurisë juridike. Sipas tyre, mënyra e re e llogaritjes së kompensimit të faturës së energjisë elektrike dhe të faturës telefonike fikse për personat e verbër, ka sjellë humbje të të drejtave të tyre ekonomike-sociale dhe standardit të fituar, duke çuar në përkeqësimin e jetesës së këtyre personave. Gjithashtu, mosparashikimi i kritereve dhe procedurave për kompensim për shërbimin e transportit, për këta persona invalidë, ka krijuar pasiguri dhe pamundësi për të realizuar të drejtat e fituara si dhe privim nga një e drejtë themelore, ajo e lëvizjes.

16. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se parimi i shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, është një nga parimet themelore në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Aspekte të këtij parimi janë edhe siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme. Parimi i sigurisë juridike, përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin tek sistemi juridik, pa marrë përsipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme (*shih vendimet nr. 43, datë 6.10.2011; nr.34, datë 28.5.2012 dhe nr.37, datë 13.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Nga ana tjetër, Gjykata është shprehur se parimi i sigurisë juridike nuk garanton çdo lloj pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Ky parim nuk mund të prevalojë në çdo rast. Kjo do të thotë se, nëse paraqitet rasti që një rregullim ligjor ndryshe i një marrëdhënieje ndikohet drejtpërdrejt nga një interes i rëndësishëm publik, me të gjitha elementet e tij thelbësore, ky interes mund të ketë përparësi ndaj parimit të sigurisë juridike *(shih vendimin nr. 26, datë 2.11.2005 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë pikëpamje, duhet parë në çdo rast se në çfarë mase dhe deri ku besimi që ka qytetari në situatën e favorshme ligjore paraqitet i rëndësishëm për t'u mbrojtur dhe cilat janë arsyet për një mbrojtje të tillë. Jo çdo masë me efekte negative që merr ligjvënësi për subjektet e ligjit është cenim i një të drejte të garantuar me Kushtetutë. Ligjvënësi jo vetëm që ka të drejtë, por është i detyruar të rregullojë nëpërmjet akteve të veta, me hollësi, të drejtat e parashikuara në Kushtetutë. Vetëm ato të drejta të cilat janë parashikuar si shprehimisht të pakufizueshme, nuk është e mundur të preken nga ligjvënësi (*shih vendimet nr. 10, datë 19.3.2008 dhe nr.37, datë 13.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata rithekson se në vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve, kjo Gjykatë niset nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën. Kjo do të thotë se, lidhur me jokushtetutshmërinë e pretenduar, duhet të parashtrohen argumente bindëse, për t'i dhënë mundësi Gjykatës të vlerësojë nëse zgjidhjet ligjore të zbatuara shkelin normat dhe vlerat kushtetuese (*shih vendimet nr.16, datë 25.07.2008 dhe nr.37, datë 13.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata konstaton se sipas ligjit nr.8098, datë 28.3.1996 "*Për statusin e të verbrit*", personat e verbër, të paaftë për të lëvizur pa shoqërues, paguanin tarifë telefonike të nivelit të parë të favorizuar dhe se shërbimi i energjisë elektrike konsistonte në pagesën e vetëm 20 % të konsumit të saj, ndërsa pjesa tjetër kompensohej nga shteti. Aktualisht, VKM-ja nr.404, datë 20.6.2012, e miratuar në zbatim të ligjit objekt kundërshtimi, parashikon për këta persona kompensimin për faturën e telefonisë fikse në masën 1 000 lekë në muaj (neni 5). Ndërsa, masa e kompensimit për energjinë elektrike është 2 000 lekë në muaj për personat e verbër që kanë nevojë për kujdestarë, (neni 2) dhe 1 400 lekë në muaj për personat që nuk kanë nevojë për kujdestarë (neni 3). Në përputhje me nenin 48 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", duke gjykuar se VKM-ja e mësipërme ka një lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e këtij gjykimi, Gjykata çmon se legjitimohet të marrë në shqyrtim edhe dispozitat e këtij

vendimi.

20. Për sa i përket përfitimit tjetër, kompensimit për transportin, ai urban ka qenë falas dhe transporti ndërurban ka qenë me gjysmë çmimi. Aktualisht, të dy këto shërbime kompensohen, por, masa, kriteret dhe procedurat e kompensimit nuk janë përcaktuar akoma nga Këshilli i Ministrave.

21. Gjykata, duke iu referuar jurisprudencës së saj, rithekson se përfitimet shtesë që u paguhen personave me aftësi të kufizuara janë pagesa që përfitohen pavarësisht nga të ardhurat e tjera që paguhen nga shteti, pra si përfitime të një natyre tërësisht/ngushtësisht personale, të patransferueshme, të patrashëgueshme dhe që gëzojnë një individualitet të dallueshëm nga pagesat apo përfitimet e tjera të kësaj kategorie. Kjo pagesë shtesë përbën një garanci më shumë në funksion të mbrojtjes dhe integrimit të kësaj kategorie në jetën normale *(shih vendimet nr.34, datë 28.5.2012 dhe nr.37, datë 13.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*.

22. Në këtë drejtim, Gjykata është shprehur se ndryshimet në përfitimet shtesë që u paguhen personave të verbër janë kryer si pasojë e ushtrimit, nga ana e institucioneve shtetërore ligjvënëse, të së drejtës për të rregulluar ndryshe një situatë ekzistuese në varësi të kërkesave që imponon evoluimi i vazhdueshëm i shoqërisë. Kjo e drejtë reflektohet në krijimin e një kuadri normativ dinamik që i përshtatet zhvillimit të shoqërisë. Në çdo rast, rregullimet që i përkasin sistemit të mbrojtjes sociale të shtetit duhet të përputhen me parimet, vlerat dhe standardet kushtetuese si dhe detyrimet që burojnë nga Karta Sociale Evropiane, që janë barazia, drejtësia sociale, respekti për të drejtat e njeriut dhe ndalimi i diskriminimit. Parime të tilla si shteti social dhe shteti i së drejtës kërkojnë që shteti, si rregullator, të vendosë kufijtë midis së mirës së përgjithshme të shoqërisë dhe të drejtave të grupeve të veçanta. Shteti duhet të niset nga trajtimi i barabartë për të gjithë dhe pastaj të kujdeset përkatësisht për kriteret e secilit grup. Ligjvënësi duhet të çmojë vetë, sipas përparësive që ai ka vendosur për zhvillimin ekonomik e shoqëror, se cilat janë format më të përshtatshme për balancimin e interesave duke bërë edhe diferencimet e arsyeshme, pa cenuar parimet dhe normat kushtetuese *(shih vendimet nr. 9, datë 26.2.2007 dhe nr.37, datë 13.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*.

23. Gjykata ka theksuar gjithashtu se mbrojtja sociale e personave me aftësi të kufizuar realizohet përmes dy mekanizmave: *së pari*, nëpërmjet zbatimit të garancive të shprehura në të drejtat dhe liritë ekonomiko-sociale, të parashikuara në Kreun IV të Kushtetutës dhe *së dyti*, nëpërmjet përmbushjes së objektivave socialë përmes materializimit të tyre në ligje, në referim të nenit 59 të Kushtetutës.

24. Përmbajtja e të drejtave ekonomiko-sociale, që për nga natyra janë të drejta pozitive, duhet interpretuar në lidhje të ngushtë me detyrimin e shtetit për t'u bërë aktiv e për t'u garantuar shtetasve sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore në rastet e fatkeqësive, të sëmundjeve, invaliditetit, pleqërisë dhe papunësisë së padëshiruar (*shih vendimet nr.33, datë 24.6.2010; nr.34, datë 28.5.2012 dhe nr.37, datë 13.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*.

25. Mbrojtja sociale realizohet edhe përmes përmbushjes së objektivave socialë që shteti synon të realizojë, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësive private. Midis të tjerash, ata përfshijnë edhe synimin për riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të personave me aftësi të kufizuar si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës. Kushtet dhe masa në të cilat mund të kërkohet realizmi i objektivave socialë i përket rezervës ligjore absolute, pra rregullimit me ligj të miratuar nga ligjvënësi.

26. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata ka vlerësuar se të drejtat sociale dallojnë nga objektivat socialë, pasi këta të fundit janë shprehje e qëllimeve të shtetit dhe parimeve të politikave të hartuara prej tij për orientimin e veprimtarisë në përgjithësi dhe, veçanërisht, të politikave sociale. Objektivat socialë janë shprehje e veprimit pozitiv të shtetit në favor të personave me aftësi të kufizuara dhe, për rrjedhojë, realizimi i tyre është ngushtësisht i lidhur me kushtet, mjetet dhe mundësitë e disponueshme buxhetore të shtetit. Në këtë drejtim, Gjykata ka vlerësuar se përmbushja e objektivave socialë nuk përfshihet në rrethin e çështjeve që i përkasin juridiksionit kushtetuese (*shih vendimet nr.34, datë 28.5.2012 dhe nr.37, datë 13.6.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*.

27. Në këto rrethana, edhe në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata vlerëson se natyra e përfitimit të kompensimit për shërbimin e transportit, energjinë elektrike dhe telefoninë fikse për shkak të aftësisë së

kufizuar të personave të verbër, është shprehje e mbrojtjes sociale, e realizuar përmes përmbushjes së objektivave socialë, në kuptim të nenit 59 të Kushtetutës. Ky përfitim, si objektiv social, përmbushet brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon Këshilli i Ministrave. Për pasojë, pretendimi i kërkuesve për cenim të parimit të sigurisë juridike, është i pabazuar dhe si i tillë, duhet rrëzuar.

***D. Lidhur me pretendimet e tjera***

28. Kërkuesit kanë pretenduar, gjithashtu, se përcaktimi i masës së përfitimit të kompensimit me VKM dhe jo me ligj është bërë në kundërshtim me nenin 52/2 të Kushtetutës, i cili sanksionon se ndihmat ekonomike për kompensimin e rrethanave të caktuara, të krijuara për shkaqe të pavarura nga vullneti i tyre, duhet të parashikohen me ligj. Gjithashtu, kufizimi i këtyre të drejtave, është bërë në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, pasi nuk justifikohet nga interesi publik apo gjendja e veçantë. Në këtë mënyrë subvencionimi ka cenuar parimin e barazisë dhe ka passjellë edhe diskriminim të personave invalidë në fjalë.

29. Gjykata çmon se përderisa pretendimet e kërkuesve nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues, nuk ka vend të analizohen pretendimet e tjera të tyre.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131 shkronja "c" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "f" të Kushtetutës; nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash:

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha.

Anëtar kundër: Sokol Berberi

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, për sa i takon rrëzimit të kërkesës së paraqitur, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice, të cilin e kam parashtruar edhe në vendimin nr. 10, datë 18.3.2013 të Gjykatës. Në këtë çështje, shumica ka arritur në përfundimin se ligji, objekt shqyrtimi, nuk cenon parimin e sigurisë juridike dhe nenin 59/2 të Kushtetutës, për arsye se kompensimi përkatës, për shkak të statusit të të verbrit, është shprehje e veprimit pozitiv të shtetit në funksion të përmbushjes së objektivave socialë, përmbushja e të cilëve nuk hyn në juridiksionin e kontrollit kushtetues. Nuk pajtohem me këtë konkluzion, për arsyet e mëposhtme.

*a) Për cenimin e sigurisë juridike*

Shumica e ka konsideruar natyrën e përfitimit të kompensimit për shërbimin e transportit, energjisë elektrike dhe telefonisë fikse, për shkak të aftësisë së kufizuar, si shprehje të mbrojtjes sociale, të dhënë nga shteti, që realizohet përmes përmbushjes së objektivave socialë. Këta të fundit, sipas shumicës, realizohen mbi bazën e kushteve, mjeteve dhe mundësive të disponueshme buxhetore të shtetit dhe në çdo rast rregullimet ligjore duhet të përputhen, ndërmjet të tjerash, me parimet, vlerat dhe standardet kushtetuese. Por, shumica, edhe pse pranon qartazi se ndërhyrja e ligjvënësit në këtë fushë nuk duhet të cenojë parimet dhe vlerat kushtetuese, pa arsyetuar dhe në mënyrë të paqartë, në përfundim, konkludon se përmbushja e objektivave socialë nuk përfshihet në rrethin e çështjeve që i përkasin juridiksionit të kontrollit kushtetues. Gjykata Kushtetuese, në shqyrtimin e çështjes konkrete, nuk vlerëson përshtatshmërinë e vlerës monetare të kompensimit, që do të nënkuptonte dhënien nga Gjykata të një drejtësie sociale, përmes çmuarjes së nivelit të trajtimit social, por vlerëson nëse ligjvënësi ka

përmbushur detyrimet kushtetuese në lidhje me kërkesat që imponon parimi i sigurisë juridike. E çmoj të rëndësishme të theksoj se ndryshimi i një situate ligjore të caktuar nuk duhet bërë në mënyrë arbitrare, pa kritere të qarta apo në kundërshtim me parimin e një shteti të së drejtës dhe social.

Detyrimi i shtetit për të ndihmuar personat me aftësi të kufizuar buron nga Kushtetuta, ndaj të drejtat ligjore me karakter social nuk mund të shmangen *a priori* nga mbrojtja që garanton parimi i sigurisë juridike. Në praktikën e saj, Gjykata është shprehur se, parimi i sigurisë juridike mbron dhe të drejta ligjore (*shih vendimin nr. 33, datë 24.6.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në rastin në shqyrtim, ligjvënësi ia ka dhënë Këshillit të Ministrave kompetencën për të përcaktuar "masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit". Mospërcaktimi i kritereve dhe parimeve, mbi bazën e të cilave do të nxirreshin në vijim aktet nënligjore, përbën një ushtrim arbitrar të veprimtarisë ligjvënëse, në kundërshtim me Kushtetutën. Ndryshimet ligjore duhet të kishin sjellë qëndrueshmëri të mjaftueshme që të siguronin vijimësinë e të drejtës së fituar dhe të mos cenonin besimin e personave me aftësi të kufizuar tek ligji. Këto ndryshime, të bëra në mungesë të parimeve dhe kritereve bazë, të cilat duhet t'i përcaktonte ligjvënësi, nuk garantojnë stabilitet dhe qartësi të mjaftueshme për të shmangur arbitraritetin. Për rrjedhojë, çmoj se ndryshimet, objekt shqyrtimi, cenojnë parimin e sigurisë juridike.

b) *Për cenimin e standardeve të përcaktuara nga nenet 3, 59/2 dhe 118 të Kushtetutës*

Shumica, pretendimet e kërkuesve për cenimin e standardeve të nenit 52/2 dhe 17 të Kushtetutës, nuk i ka marrë në shqyrtim me arsyetimin se këto pretendime nuk mund të vlerësohen nga Gjykata, përderisa përmbushja e objektivave socialë nuk përfshihet në rrethin e çështjeve që i përkasin juridiksionit të kontrollit kushtetues.

Ky konkluzion i shumicës, siç u përmend dhe më sipër, nuk ndjek në mënyrë logjike dhe koherente standardet, të cilave vetë shumica u referohet në arsyetimin e vendimit (*shih paragrafët 22 dhe 25 të vendimit)*. Në ndryshim nga shumica, gjykoj se neni 59/2 i Kushtetutës vendos detyrime për ligjvënësin, të cilat duhet të ishin vlerësuar nga Gjykata në çështjen objekt shqyrtimi. Sipas kësaj dispozite, ligji duhet të përcaktojë kushtet dhe masën në të cilat mund të kërkohet realizimi i objektivave socialë. Përcaktime të ngjashme i hasim edhe në një sërë dispozitash të tjera të Kushtetutës, të cilat vendosin detyrime për Kuvendin, me qëllim që veprimtaria ligjvënëse të ushtrohet brenda kufijve të përcaktuar dhe në garantim të plotë të të drejtave themelore kushtetuese. Kështu, mund të përmendim nenet 15/2; 17/1; 118/2; 52/2 të Kushtetutës. Në vështrim të këtyre neneve, të cilat vendosin detyrime të qarta për ligjvënësin, në rastin në shqyrtim, shumica nuk ka kontrolluar nëse këto detyrime janë përmbushur apo jo nga ligjvënësi. Gjykoj se ligji, objekt shqyrtimi, në kundërshtim me standardet e mësipërme, i delegon Këshillit të Ministrave, kompetencën normative për të përcaktuar masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të kompensimit për shërbimin e transportit, faturës së energjisë elektrike dhe telefonisë fikse. Kuvendi, nëpërmjet këtij delegimi, pa përcaktuar parimet dhe kushtet mbi bazën e të cilave do të ushtrohet kompetenca për të nxjerrë aktet nënligjore, i ka njohur Ekzekutivit një diskrecion të pakufizuar dhe, për rrjedhojë, nuk ka përmbushur detyrimin e tij kushtetues. Ligji duhet të kufizojë dhe përcaktojë autorizimin ekzekutiv për të nxjerrë akte nënligjore në përmbajtje, objekt, qëllim dhe fushëveprim, në mënyrë që ndërhyrja e shtetit të jetë e kuptueshme dhe e parashikueshme nga qytetarët. Një dispozitë deleguese e paqartë dhe jo përcaktuese konflikton me parimin e ligjshmërisë, në përputhje me të cilin duhet të funksionojë Këshilli i Ministrave. Gjithashtu, këtë e dikton edhe parimi i ndarjes së pushteteve. Nëse ligji delegues nuk përcakton në mënyrë të përshtatshme kompetencat ekzekutive, atëherë Ekzekutivi nuk do të zbatojë ligjin dhe as do të veprojë brenda kritereve ligjore, por me vendimet e tij do të zëvendësojë ligjvënësin.

Në përfundim, bazuar në argumentet e paraqitura më lart, çmoj se ligji objekt shqyrtimi nuk respekton parimin e sigurisë juridike dhe kërkesat që burojnë nga nenet 59/2 e 118 të Kushtetutës dhe Gjykata, në këtë rast, duhet të kishte vendosur pranimin e kërkesës dhe shfuqizimin e ligjit.

Anëtar: Sokol Berberi

**VENDIM**
**Nr. 15, datë 19.4.2013**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | |
|---|---|---|---|
| Bashkim Dedja | Kryetar | i | Gjykatës Kushtetuese |
| Xhezair Zaganjori | Anëtar | i | “ “ |
| Vitore Tusha | Anëtare | e | “ “ |
| Sokol Berberi | Anëtar | i | “ “ |
| Admir Thanza | Anëtar | i | “ “ |
| Altina Xhoxhaj | Anëtare | e | “ “ |
| Fatmir Hoxha | Anëtar | i | “ “ |
| Vladimir Kristo | Anëtar | i | “ “ |

me sekretare Elta Milori, në datën 13.11.2012 dhe 18.12.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr.42/16 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Pranvera Duhanxhiu, përfaqësuar me prokurë nga avokat Arben A. Hakani.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Nazmije Ferhati, në mungesë; Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Tiranë, në mungesë; Drejtoria e privatizimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, i vendimit nr.2266, datë 27.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; i vendimit nr.10-2009-1031 (503), datë 8.12.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe i vendimit nr.00-2012-820, datë 12.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut; ligji nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; neni 451/a i Kodit të Procedurës Civile.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Vladimir Kristo, shqyrtoi pretendimet e përfaqësuesit të kërkueses, i cili kërkoi pranimin e kërkesës dhe, pasi e diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Me vendimin nr.224/4 prot., datë 17.6.1996, ish-Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Elbasan, i ka njohur pronësinë trashëgimtarëve të z. Hysen Abdihoxha, për një sipërfaqe trualli prej 80 m2, nga të cilat 21,6 m2 truall gjenden nën objektin librari, me një sipërfaqe totale prej 57,6 m2, duke i dhënë të drejtën e parablerjes për këtë objekt, kur të privatizohet, dhe kompensim me obligacione për sipërfaqen tjetër prej 58,4 m2, të zënë nga një pallat 5-katesh dhe trotuar.

2. Kërkuesja, në cilësinë e një prej trashëgimtarëve të z. Hysen Abdihoxha, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke ankimuar vendimin e KKKP-së Elbasan me pretendimin, ndërmjet të tjerash, se sipërfaqja e truallit nën objektin librari është më e madhe se 21,6 m2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr.89, datë 21.5.2005, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, ndryshimin e vendimit nr.224/4 prot., datë 17.6.1996, të KKKP-së Elbasan, duke u njohur trashëgimtarëve të z. Hysen Abdihoxha të drejtën e parablerjes së librarisë, kur të privatizohet, e cila zë 48 m2 të sipërfaqes prej 80 m2, të njohur nga ky komision, dhe kompensim me obligacione për pjesën tjetër të sipërfaqes të zënë nga një pallat 5- katesh dhe trotuar. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 9.2.2005.

3. Në datën 27.2.2007, subjekti i interesuar, Nazmije Ferhati, në cilësinë e qiramarrëses (librashitëse) së objektit librari, të lartpërmendur, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan

me objekt kundërshtimin e vendimit nr.224/4 prot., datë 17.06.1996 të ish-KKKP-së Elbasan. Ajo pretendon se ndërtesa librari nuk ndodhet në sipërfaqen ish-pronë e z. Hysen Abdihoxha, pra nuk ka mbivendosje ndërmjet sipërfaqeve përkatëse. Po ashtu, subjekti i interesuar, paditësja në atë gjykim, Nazmije Ferhati, parashtron se libraria është pronë shtetërore në administrim të Drejtorisë së Tregtimit të Librit Artistik dhe Shkencor SHA, dhe se aktualisht ekziston një kontratë qiraje ndërmjet saj dhe kësaj Drejtorie, pasi ende nuk kanë përfunduar procedurat e privatizimit të objektit, të filluara ndërmjet tyre që prej vitit 1996. Në këtë gjykim ka bërë kërkesë për ndërhyrje kryesore Drejtoria e Privatizimit të Ndërmarrjeve të Vogla e të Mesme, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr.2266, datë 27.11.2007, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, ndryshimin e vendimit nr.224/4 prot., datë 17.6.1996 të KKKP-së Elbasan, duke anuluar këtë vendim në pjesën që i jep trashëgimtarëve të z. Hysen Abdihoxha të drejtën e parablerjes për objektin librari.

5. Gjykata e Apelit Durrës, në bazë të ankimit të kërkueses, me vendimin nr.10-2009-1031 (503), datë 8.12.2009, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.2266, datë 27.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2012-820, datë 12.4.2012, ka vendosur, në dhomë këshillimi, mospranimin e rekursit të ushtruar nga kërkuesja, pasi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së.

II

7. Kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim "Gjykata") duke pretenduar shfuqizimin e vendimeve objekt kërkese. Ajo ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

7.1 Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë cenuar parimin e gjësë së gjykuar, pasi në vendimet e tyre nuk kanë mbajtur parasysh vendimin e formës së prerë nr.89, datë 21.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

7.2 Është cenuar e drejta për gjykim nga një gjykatë e paanshme, për shkak se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë vendosur në kundërshtim me normat procedurale në lidhje me ndërgjyqësinë. Në këtë drejtim, Gjykata e Lartë, duke mos kaluar çështjen në seancë gjyqësore, ka cenuar dhe parimin e barazisë së armëve.

7.3 Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë shkelur parimin e ligjshmërisë në marrjen e provave, pasi gjatë gjykimit në shkallë të parë provat janë marrë në kundërshtim me formën dhe rregullat procedurale themelore dhe gjykatat e shkallëve më të larta nuk kanë plotësuar apo korrigjuar mangësitë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor.

7.4 Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar nenin 142/1 të Kushtetutës që sanksionon detyrimin e arsyetimit të vendimit, pasi ky vendim nuk arsyeton shkaqet e mospranimit tij, edhe pse nga kërkuesja janë pretenduar shkelje të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta si dhe shkaqe (shkelje procedurale) të parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

III

***Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese***

***A. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor***

*A.1. Në lidhje me qëndrimin e Gjykatës së Lartë për cenimin e parimit të sigurisë juridike*

8. Kërkuesja pretendon se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, me vendimet për të cilat kërkohet shfuqizimi, duke anuluar pjesën e vendimit nr.224/4 prot., datë 17.6.1996, të KKKP-së Elbasan, që i jep trashëgimtarëve të z. Hysen Abdihoxha, të drejtën e parablerjes për objektin librari, kur të privatizohet, nuk kanë mbajtur parasysh vendimin e formës së prerë nr.89, datë 21.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, i cili u ka njohur atyre (trashëgimtarëve) këtë të drejtë (të parablerjes), duke cenuar në këtë mënyrë parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*).

9. Në jurisprudencën e saj Gjykata, në lidhje me parimin *res judicata*, ka vlerësuar se vendimi gjyqësor i formës së prerë, që përbën gjë të gjykuar, është shprehje dhe konkretizim i të drejtës mbi

marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por dhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Pra, kur vendimi ka marrë formë të prerë ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimin nr. 23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në çështjen objekt shqyrtimi, Gjykata vlerëson se në vendimet gjyqësore objekt kundërshtimi dhe në vendimin nr.89, datë 21.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, edhe pse *prima facie* pretendimet e palëve ndërgjyqëse shfaqen si të ndryshme, në thelb ato kanë objekt të njëjtë, vendndodhjen e ish-pronës të z. Hysen Abdihoxha dhe vendndodhjen e objektit librari.

11. Nga ana tjetër, Gjykata çmon se edhe pse nuk ndodhemi në kushtet e kuptimit klasik të "*gjësë së gjykuar*", meqenëse vendimi nr.89, datë 21.5.2005, ka palë ndërgjyqëse të ndryshme nga ato të vendimeve të kundërshtuara, nuk mund të anashkalohet fakti që ndodhemi para të njëjtit objekt padie dhe para të njëjtit shkak ligjor të gjykuar njëherë. Duke iu referuar jurisprudencës së saj, Gjykata ka çmuar se parimi i gjësë së gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t'i përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimin nr. 24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit, në vendimet e tyre, objekt shqyrtimi, në pjesën kur analizojnë vendimin nr.89, datë 21.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nuk kanë mbajtur parasysh përfundimet dhe pjesën arsyetuese të këtij të fundit.

13. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, rikonfirmon qëndrimin se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e kësaj Gjykate të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 19 datë 2.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Për pasojë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin e kërkueses për cenimin e parimit të sigurisë juridike. Ky fakt, edhe për arsyet që do të analizohen më poshtë, cenon parimin e arsyetimit të vendimit të mospranimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

*A.2. Në lidhje me mosparaqitjen, në vendimin e Gjykatës së Lartë, të shkaqeve të parashtruara nga kërkuesja në rekurs*

14. Sipas kërkueses, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk është i arsyetuar, pasi nuk paraqiten shkaqet e mospranimit të rekursit të saj, edhe pse ajo ka pretenduar shkelje të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat më të ulëta, si dhe shkaqe të parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

15. Gjykata rithekson se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42, 142/1 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë *(shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 25, datë 10.6.2011 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

16. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi

faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

17. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik *(shih vendimet nr. 20, datë 13.4.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

18. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr.25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit, e cila mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese)*.

19. Po në këtë drejtim, neni 310/1 i KPC-së parashikon se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar, në paragrafët e tjerë, elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve. Ndërsa për gjykimin në Gjykatën e Lartë, KPC-ja sanksionon se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështetet (neni 475/ç) dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit (neni 480).

20. Nga parashikimet e dispozitave të KPC-së, të lartpërmendura, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata ka çmuar se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese)*.

21. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i mospranimit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përmban, në pjesën hyrëse të tij, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit kanë paraqitur rekurs dhe kundërrekurs përkatësisht kërkuesja dhe subjekti i interesuar, por nuk përmban shkaqet që ata kanë parashtruar në rekurs dhe kundërrekurs. Ndërsa, në pjesën arsyetuese, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është mjaftuar me përfundimin se rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së, duke vendosur, në pjesën urdhëruese, mospranimin e tij. Pra, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se në vendim nuk paraqet cilat janë shkaqet e kundërshtimit të vendimit të apelit, ka arritur të bëjë një proces vlerësimi të tyre (shkaqeve) nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur në

dispozitiv.

22. Gjykata, është shprehur tashmë se, *prima facie*, mosparaqitja, në vendimin e Kolegjit Civil, e shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi në rekurs, krijon dyshime edhe mbi cenimin e të drejtës së ankimit efektiv si dhe të të drejtës për t'u dëgjuar, të pretenduara nga kërkuesi. Në këtë këndvështrim, pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor (*shih vendimin nr. 3, datë 19.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese)*.

23. Për pasojë, nga leximi në tërësi i vendimit, Gjykata vlerëson se, për shkakun e lartpërmendur, rrjedha logjike e përdorur në vendim nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Ato nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që përmbajtja dhe arsyetimi i tij të mos kenë një harmoni të brendshme. Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës.

***B. Për pretendimet e tjera***

24. Në analizën e pretendimeve të tjera të kërkueses, Gjykata sheh të arsyeshme të theksojë, paraprakisht, se ajo i vlerëson këto pretendime në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, në aspektin e detyrimeve që i ngarkon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm respektimi i standardeve kushtetuese.

25. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar sipas të cilit interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr.31, datë 5.7.2011; nr.22, datë 22.7.2009 dhe nr.14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

26. Nisur nga kjo premisë si dhe nga objekti i mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses, se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë shkelur normat procedurale në lidhje me ndërgjyqësin, ka të bëjë me zbatimin e ligjit nga ana e tyre. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se ky pretendim nuk hyn në juridiksionin kushtetues, përderisa kërkuesja nuk ka përcaktuar se cilat standarde kushtetuese i janë cenuar si rezultat i këtij interpretimi apo shkeljeje.

27. Ndërsa, për sa i përket pretendimit për cenimin e parimit të paanshmërisë nga ana e gjykatave të zakonshme, Gjykata, në jurisprudencën e saj, edhe nën dritën e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ka analizuar dhe ka dhënë përkufizimet e nevojshme mbi nocionin "*gjykatë e paanshme*", duke theksuar se ky parim ka të bëjë kryesisht me përbërjen e trupit gjykues. Për këtë arsye, Gjykata vëren se pretendimi i kërkueses për cenimin e këtij parimi, bazuar në mënyrën e interpretimit të ligjit, është i pabazuar.

28. Kërkuesja pretendon, gjithashtu, se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë shkelur parimin e ligjshmërisë në marrjen e provave, pasi dokumentet e administruara si prova në gjykimin në shkallën e parë, janë fotokopje të thjeshta. Të meta të tjera të dosjes gjyqësore, sipas kërkueses, janë mungesa e padisë së ndërhyrësit kryesor (ky subjekt ka paraqitur vetëm kërkesë për ndërhyrje në proces, pa e shoqëruar me padi) dhe fakti se ky i fundit është legjitimuar në proces pa një vendim të ndërmjetëm.

29. Gjykata konstaton se kërkuesja, apo mbrojtësi i saj, nuk kanë parashtruar pretendimin për shkeljen e parimit të ligjshmërisë në marrjen e provave, në rekursin që gjendet i depozituar në dosjen gjyqësore. Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kërkuesi mund t'i drejtohet kësaj Gjykate për pretendime që kanë lidhje me cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Juridiksioni kushtetues për shkeljen e të drejtave themelore për një proces të rregullt ligjor bëhet i mundur kur kërkuesi shteron mjetet juridike të ankimit në gjykatat e zakonshme. Shterimi i mjeteve juridike, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, kërkon që individi të

shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për rivendosjen e të drejtave të pretenduara *(shih vendimet nr.1, datë 25.1.2010; nr.36 datë 10.11.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

30. Shterimi i mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet të përmbushet nga kërkuesi, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Ky rregull nënkupton jo vetëm që kërkuesi t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr.6, datë 4.3.2010; nr.32, datë 28.12.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

31. Në vështrim të standardeve të mësipërme kushtetuese si dhe të rrethanave të çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, për rrjedhojë, nuk mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të ligjshmërisë në marrjen e provave.

32. Si përfundim, Gjykata çmon se vendimi i mospranimit të rekursit, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si për faktin që nuk ka mbajtur qëndrim lidhur me pretendimin e kërkueses për cenimin e parimit të sigurisë juridike (shih paragrafët 10-13 të këtij vendimi), ashtu edhe për shkak të mungesës, në përmbajtjen e tij, të paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs (shih paragrafët 21-23 të këtij vendimi). Për rrjedhojë, pretendimi i kërkueses në këtë aspekt është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, shkronja "f" dhe nenit 134, pika 1, shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.[1]
- Shfuqizimin e vendimit nr.00-2012-820, datë 12.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Admir Thanza, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj

Anëtar kundër: Xhezair Zaganjori

MENDIM PARALEL

Në çështjen konkrete pajtohemi me vendimin e shumicës për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2012-820, datë 12.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, por çmojmë se shumica duhej të pranonte tërësisht kërkesën duke shfuqizuar të tri vendimet gjyqësore, objekt të saj. Për këtë arsye e vlerësojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim paralel.

Shumica, në këtë çështje, ka konkluduar se Gjykata e Lartë duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin e kërkueses për cenimin e parimit të sigurisë juridike. Ky fakt, ndërmjet

[1] Gjyqtarët V. Kristo, S. Berberi dhe F. Hoxha kanë votuar për pranimin tërësisht të kërkesës, pra për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të tri shkallëve të gjykimit, ndërsa gjyqtarja V. Tusha ka votuar për shfuqizimin edhe të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës.

të tjerash, cenon, sipas shumicës, parimin e arsyetimit të vendimit të mospranimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Ndryshe nga shumica, në këndvështrimin tonë, të tri vendimet gjyqësore, objekt shqyrtimi, paraqesin probleme kushtetuese në drejtim të cenimit të parimit të sigurisë juridike, si një nga elementet esenciale të procesit të rregullt ligjor.

Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se, në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim i cili pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Ashtu siç ka pranuar edhe shumica, cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që, kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në diskutim *(shih vendimet nr. 24, datë 12.11.2008 dhe nr. 23, datë 8.6.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila ka nënvizuar se "..në pikëpamjen e Gjykatës, parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një efekt përfundimtar, është një element themelor i të drejtës për një gjykim të drejtë që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile. Parimi i sigurisë juridike dikton që kur një mosmarrëveshje civile është shqyrtuar në themel nga gjykata, vendimi i saj nuk vihet më në diskutim" (*shih çështjen Kehaya dhe të tjerë kundër Bullgarisë, datë 12.1.2006)*. GJEDNJ-ja, në disa çështje kundër Shqipërisë (*shih Ramadhi dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, datë 13.11.2007; *Hamzaraj kundër Shqipërisë (nr. 1),* datë 3.2.2009; *Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, datë 31.7.2012) ka evidentuar rëndësinë e sigurisë juridike në procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave, veçanërisht për sa i përket të drejtave të fituara nga vendimet që kanë njohur të drejta pronësie dhe të ruajtjes së garancive që lidhen me këto të drejta.

Siç ka pohuar edhe shumica, vendimet gjyqësore, objekt kundërshtimi dhe vendimi i formës së prerë nr. 89, datë 21.5.2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, në thelb kanë objekt dhe shkak ligjor të njëjtë. Sipas jurisprudencës kushtetuese, parimi i gjësë së gjykuar shtrihet jo vetëm në urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe në vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit (*shih vendimin nr. 24, datë 12.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në vijim të arsyetimit dhe standardeve të mësipërme, vlerësojmë se vendimet nr. 2266, datë 27.11.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe nr. 10-2009-1031 (503), datë 8.12.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës, cenojnë parimin e gjësë së gjykuar, e rrjedhimisht edhe parimin e sigurisë juridike. Shumica duhej të shfuqizonte këto dy vendime për arsye sepse ato disponojnë mbi një gjë të gjykuar, që është e drejta e parablerjes, e cila i është njohur kërkueses me vendim gjyqësor të formës së prerë. Duke qenë se Gjykata e Lartë nuk e ka konsideruar pretendimin e kërkueses për cenimin e parimit të gjësë së gjykuar nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, edhe vendimi i saj duhej të shfuqizohej për shkakun se ka lejuar një proces të parregullt në aspektin kushtetues.

Gjykata, si rregull, në përputhje me nenin 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", e dërgon çështjen për shqyrtim në atë gjykatë ku është konstatuar shkelja, e cila ka passjell shfuqizimin e vendimit të po kësaj gjykate (*shih dispozitivin e vendimeve nr. 4, datë 10.2.2012; nr. 40, datë 22.9.2011 dhe nr. 14, datë 3.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këto kushte, arrijmë në përfundimin se shumica, në rastin konkret, duhej të shfuqizonte të tri vendimet gjyqësore, objekt kërkese, dhe të dërgonte çështjen për shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Anëtarë: Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen konkrete pajtohem me vendimin e shumicës për shfuqizimin e vendimit nr.00-2012-820, datë 12.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, por, ndryshe nga qëndrimi i shumicës, vlerësoj se rivendosja e të drejtave të kërkueses, që burojnë nga kuptimi i parimit të sigurisë juridike, bëhet i mundur duke shfuqizuar vendimin nr.10-2009-1031(503), datë 8.12.2009 të Gjykatës së Apelit Durrës.

2. Shumica ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit, në vendimet e tyre, objekt shqyrtimi, në pjesën kur analizojnë vendimin nr.89, datë 21.5.2005 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nuk kanë mbajtur parasysh përfundimet dhe pjesën arsyetuese të këtij të fundit. Ky qendrim i shumicës nuk mund të kuptohet veç se vendimet gjyqësore, objekt shqyrtimi, paraqesin probleme kushtetuese në drejtim të cenimit të parimit të sigurisë juridike, si një nga elementet esenciale të procesit të rregullt ligjor. Megjithatë, shumica, duke iu referuar parimit të subsidiaritetit, argumenton se detyrimin për të mbajtur qëndrim të shprehur lidhur me pretendimin e kërkueses për cenimin e parimit të sigurisë juridike në rastin konkret e ka vetëm Gjykata e Lartë.

3. Gjykata ka theksuar se gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Po ashtu, Gjykata është shprehur se përbën cenim të parimit për një proces të rregullt ligjor rasti kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, nuk ka plotësuar apo nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor *(shih vendimin nr.5, datë 25.2.2013 të Gjykatës Kushtetuese)*.

4. Nga sa më sipër, në referim të nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile, në shqyrtimin në apel mbahen parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë. Me kërkesë të palëve ose edhe kryesisht, gjykata e apelit përsërit tërësisht ose pjesërisht hetimin gjyqësor. Në shqyrtimin gjyqësor mund të lexohen aktet e gjykimit në shkallë të parë dhe po ashtu, gjykata ka të drejtë të marrë edhe prova të reja. Nisur nga këto kompetenca të Gjykatës së Apelit, vlerësoj se kjo e fundit e shqyrton çështjen duke iu referuar krahas ligjit edhe fakteve konkrete dhe provave.

5. Në respekt të parimit të subsidiaritetit, të ekonomisë gjyqësore dhe të administrimit sa më praktik të drejtësisë, po ashtu, bazuar në kufijtë e ndryshëm ligjorë të shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë me atë të Apelit, si dhe nisur nga natyra e rrethanave të çështjes konkrete mendoj se shumica duhej të shfuqizonte edhe vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës. Kjo për arsye se është pikërisht kjo Gjykatë, e cila gëzon kompetencën për të arsyetuar nëse vendimi i formës së prerë, me të cilin kërkueses i është njohur e drejta e parablerjes, gëzon cilësitë e gjësë së gjykuar.

6. Në vështrim të sa më sipër, vlerësoj se shkelja e të drejtës së kërkueses për një proces të rregullt ligjor nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nuk është plotësuar ose korrigjuar as nga Gjykata e Apelit Durrës dhe as nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Në këto kushte, çmoj se rivendosja e të drejtave të cenuara të kërkueses bëhet i mundur përmes kthimit të çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Durrës.

Anëtare: Vitore Tusha

**VENDIM**
**Nr. 16, datë 19.4.2013**

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Bashkim Dedja | Kryetar | i | Gjykatës | Kushtetuese |
| Vladimir Kristo | Anëtar | i | “ | “ |
| Xhezair Zaganjori | Anëtar | i | “ | “ |
| Vitore Tusha | Anëtare | e | “ | “ |
| Sokol Berberi | Anëtar | i | “ | “ |
| Altina Xhoxhaj | Anëtare | e | “ | “ |
| Fatmir Hoxha | Anëtar | i | “ | “ |
| Admir Thanza | Anëtar | i | “ | “ |

me sekretare Blerina Basha, në datën 30.10.2012, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr. 35/10 Akti, që i përket:

KËRKUES: SHOQËRIA “Kla & Xhu” SHPK, përfaqësuar nga avokat Shpëtim Beqiraj dhe avokat Erind Merkuri, me autorizim.

SUBJEKT I INTERESUAR: Shoqëria “Alban Tirana Co” shpk, përfaqësuar nga avokat Kujtim Puto dhe avokat Sokol Lamaj, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: 1- Shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, i vendimit nr. 00-2012-785, datë 5.4.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; vendimit nr. 1990, datë 4.10.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimit nr. 2, datë 5.1.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2- Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë.

3- Detyrimi i subjektit të interesuar, shoqëria “Alban Tirana Co” shpk, që të kthejë sendin e marrë në pronësi dhe ngarkimi i përmbaruesit privat, Besnik Bajraktari, për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese**.**

BAZA LIGJORE: Nenet 16/2, 42, 131/f dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 28, 29, 30, 45 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”; Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të kësaj konvente.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Admir Thanza, përfaqësuesin e kërkuesit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, i cili kërkoi rrëzimin e kërkesës, dhe pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

***Rrethanat e çështjes***

1. Mbështetur në aktet ndodhur në dosjen gjyqësore, rezulton se shoqëria “KLA & XHU” SHPK (kërkuesi) dhe shoqëria “Alban Tirana Co” SHPK (subjekti i interesuar), në datën 26.06.2003, kanë lidhur përpara noterit një kontratë sipërmarrjeje, me nr. 3751 Rep. dhe nr. 892 Kol.

2. Duke konsideruar se kërkuesi nuk kishte ekzekutuar detyrimet që buronin nga kjo kontratë, subjekti i interesuar i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi për të vendosur rreth pasojave të këtij mosekzekutimi.

3. Gjatë gjykimit, kërkuesi ngriti një kundërpadi ndaj subjektit të interesuar.

4. Pasi shqyrtoi çështjen, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 2, datë 5.1.2011, vendosi të pranojë pjesërisht padinë dhe të rrëzojë kundërpadinë.

5. Kundër këtij vendimi, si kërkuesi ashtu edhe subjekti i interesuar, ushtruan të drejtën e ankimit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë e cila, me vendimin nr. 1990, datë 4.10.2011, vendosi lënien në fuqi të tij.

6. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 436, datë 18.11.2011, vendosi të pezullojë ekzekutimin e vendimit nr. 2 të sipërpërmendur.

7. Kundër vendimeve të sipërcituara, kërkuesi i është drejtuar me rekurs Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil i së cilës, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2012-785, datë 05.04.2012, vendosi mospranimin e tij për shkak se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

8. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar fillimisht, ndër të tjera, pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. 2, datë 05.01.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Më pas, gjatë gjykimit të çështjes kërkuesi u tërhoq me shkrim nga kjo kërkesë me arsyetimin se ky vendim ishte ekzekutuar plotësisht.

II

***Pretendimet e palëve parashtruar Gjykatës Kushtetuese***

9. ***Kërkuesi*** pretendon se vendimet objekt të kërkesës duhet të shfuqizohen si të papajtueshme me Kushtetutën, për arsye se janë marrë si rrjedhojë e zhvillimit të një procesi jo të rregullt ligjor. Këtë pretendim kërkuesi e argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

9.1 *Është shkelur parimi i disponibilitetit*. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është shprehur tej kërkimeve që ka përcaktuar subjekti i interesuar në objektin e kërkesëpadisë si dhe ka ndryshuar bazën ligjore të padisë, pa pasur një kërkesë nga palët në proces.

9.2 *Është cenuar parimi i barazisë së armëve*. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka mohuar mundësinë kërkuesit për të marrë dhe paraqitur disa prova, me arsyetimin e gabuar se ato prova nuk ishin të nevojshme dhe kërkoheshin me qëllimin për të vonuar gjykimin. Gjithashtu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk i ka dhënë përgjigje disa pretendimeve të kërkuesit që lidheshin me prova të paraqitura prej tij.

9.3 *Gjykatat e kanë mbështetur vendimin e tyre mbi prova të marra në mënyrë të paligjshme*. Ekspertët, për të përcaktuar vlerën e objektit, janë bazuar në disa standarde dhe dokumente të cilat nuk janë administruar në dosjen gjyqësore si dhe janë bazuar në disa harta numerike të marra nga interneti, në kundërshtim me ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 "Për dokumentin elektronik".

9.4 *Është shkelur parimi i kontradiktoritetit dhe i të drejtës së mbrojtjes në gjykim*. Subjekti i interesuar ka bërë kërkime të reja gjatë pretendimeve përfundimtare. Për shkak se ishte mbyllur hetimi gjyqësor, kërkuesi nuk mund të paraqiste prova apo argumente kundër kërkimeve të reja të subjektit të interesuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbas mbylljes së hetimit, duhej të jepte vendimin përfundimtar dhe nuk mund të bënte veprime të tjera procedurale. Në kundërshtim me nenin 309 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vënë në themel të vendimit të saj të gjitha kërkimet e subjektit të interesuar, parashtruar në pretendimet përfundimtare. Në këtë mënyrë, gjykata është mbështetur mbi fakte që nuk janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor.

9.5 *Është cenuar e drejta për të marrë pjesë në gjykim.* Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka njoftuar kërkuesin për disa seanca gjyqësore. Ky veprim i ka mohuar kërkuesit mundësinë për të kundërshtuar vendimin e ndërmjetëm për shtimin e objektit të padisë. Gjithashtu, i ka mohuar mundësinë për të kundërshtuar përllogaritjen që gjykata i bëri vlerës së taksës gjyqësore e cila, si rregull, i ngarkohet humbësit të gjyqit. Më tej, mosnjoftimi i mohoi kërkuesit mundësinë për të kërkuar përjashtimin e trupit gjykues, pasi ky veprim mund të konsiderohet si një shfaqje njëanshmërie.

9.6 *Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e paanshme*. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka pasqyruar togfjalëshin "në shumën 275 256 834 lekë" në objektin e padisë së paraqitur në vendimin e saj, edhe pse ky togfjalësh figuron në objektin e padisë së ngritur nga subjekti i interesuar. Gjithashtu, gjatë gjykimit, kjo gjykatë ka pranuar të gjithë kërkesat e subjektit të interesuar, madje duke shtyrë edhe tre herë shpalljen e vendimit vetëm për t'i dhënë mundësi subjektit të interesuar për të paguar diferencën e taksës gjyqësore. Ndërsa kërkuesit i ka mohuar marrjen e provave nga organet tatimore, ka

mohuar mundësinë për të paraqitur provat e reja të kërkuara nga ekspertët në lidhje me kundërpadinë si dhe nuk ka kryer njoftimet për seancat.

9.7 Është cenuar standardi kushtetues sipas të cilit vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përmban kontradikta të hapura. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë nuk i kanë dhënë përgjigje disa pretendimeve të kërkuesit. Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim kontradiktor.

9.8 Gjykata e Lartë, nisur nga shkeljet e mësipërme duhej ta kalonte domosdoshmërisht çështjen për shqyrtim në seancë dhe të mbante një qëndrim të shprehur rreth këtyre shkeljeve. Megjithatë, për shkak të natyrës së shkeljeve, çështja nevojitet të dërgohet për rigjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

9.9 *Është cenuar parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe barazisë në të drejta*. Barazia në të drejta, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme në çështje të ngjashme nga gjykatat e zakonshme. Gjykatat, edhe pse kërkuesi i është referuar në kërkesë, nuk kanë respektuar vendimin unifikues nr. 9, datë 09.03.2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

9.10 Zbatimi i vendimit nr. 2, datë 05.01.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet pezulluar. Nëse ky vendim do të ekzekutohej, kthimi i palëve në gjendjen e mëparshme, në rast se Gjykata Kushtetuese do të shfuqizonte vendimet objekt kërkese, do të bëhej praktikisht i pamundur.

10. ***Subjekti i interesuar***, në seancë gjyqësore paraqiti prapësimet si më poshtë:

10.1 Nuk është cenuar parimi i disponibilitetit të padisë, pasi të gjitha kërkimet e pranuara nga gjykatat si dhe baza ligjore kanë qenë të parashikuara në objektin e padisë.

10.2 Nuk është cenuar parimi i barazisë së armëve, pasi gjykata nuk është e detyruar të pranojë çdo kërkesë që paraqesin palët për marrjen e provave nëse arsyeton në mënyrë të mjaftueshme shkaqet e refuzimit të saj. Gjykatat nuk ishin të detyruara të trajtonin çdo pikë të argumenteve që parashtrojnë palët, pasi arsyetimi i vendimit varet nga natyra e çështjes dhe rrethanat e saj.

10.3 Është i pabazuar pretendimi i kërkuesit se gjykatat kanë mbështetur vendimet e tyre mbi prova të mbledhura në mënyrë të jashtëligjshme. Hartat janë përdorur për të përcaktuar vendndodhjen e objektit dhe nuk ka pasur asnjë kontestim nga palët mbi këtë përdorim. Këto harta nuk kanë influencuar zgjidhjen e çështjes dhe, për pasojë, nuk kanë rëndësi për këtë gjykim.

10.4 Pretendimi i kërkuesit për shkelje të parimit të kontradiktoritetit dhe të të drejtës së mbrojtjes në gjykim është i pabazuar, për shkak se nuk ka ndodhur asnjë ndryshim i objektit apo i shkakut ligjor të padisë.

10.5 Hetimi gjyqësor ishte i mbyllur dhe mosnjoftimi i palëve për seancën e shpalljes së vendimit nuk përbën shkelje procedurale, sepse në rast mungese vendimi komunikohet nga gjykata. Rrjedhimisht, mungesa e kërkuesit nuk ka sjellë asnjë pasojë në shkeljen e të drejtave të tij në proces.

10.6 Nuk konstatohet asnjë njëanshmëri, në kuptimin objektiv, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pretendimi i kërkuesit për cenim të parimit të paanshmërisë i referohet mënyrës sesi është shkruar vendimi, çka është një çështje që ka të bëjë me bindjen e brendshme të gjykatës, pra lidhet me testin subjektiv të paanshmërisë. Në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), paanshmëria subjektive e gjyqtarit prezumohet deri sa të provohet e kundërta dhe në çështjen konkrete nuk ka asnjë të dhënë që gjykata të ketë qenë e njëanshme në këtë aspekt.

10.7 Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i përmbush tërësisht kërkesat e një vendimi të arsyetuar, pasi gjykatat nuk kanë nevojë të japin përgjigje për çdo argument të parashtruar për sa kohë argumentet përcaktuese për zgjidhjen e çështjes janë trajtuar. Në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së një gjykatë apeli nuk nevojitet të arsyetojë në mënyrë të plotë vendimin e saj, pasi ajo mund të pajtohet me arsyetimin e gjykatës më të ulët duke e përfshirë këtë arsyetim në vendimin e saj.

10.8 Gjykata Kushtetuese ka një jurisprudencë të konsoliduar sipas së cilës verifikimi nëse rekursi i plotëson ose jo kushtet për shqyrtim është atribut i dhomës së këshillimit dhe, për pasojë, vendimmarrja e Gjykatës së Lartë nuk përbën shkelje të së drejtës së kërkuesit për akses në këtë gjykatë. Shkaqet e pezullimit të ekzekutimit të vendimit nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe shkaqet e mospranimit të rekursit nga po ky kolegj janë krejtësisht të ndryshme.

III

***Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese***

***A. Mbi cenimin e parimit të barazisë së armëve***

11. Kërkuesi pretendon se gjatë gjykimit të çështjes pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është cenuar parimi i barazisë së armëve. Sipas tij, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk duhej të refuzonte kërkesën për të urdhëruar organet tatimore që t'i komunikojnë atij librat e shitjes dhe të blerjes të subjektit të interesuar. Më tej, kjo gjykatë duhej të shtynte seancën e datës 01.12.2010 në mënyrë që t'i mundësonte kërkuesit paraqitjen e disa provave. Po kështu, kjo gjykatë ka cenuar këtë parim edhe për shkak se nuk i ka dhënë përgjigje kërkuesit për disa pretendime që lidheshin me prova të paraqitura prej tij.

12. Gjykata rithekson se përpara se të shqyrtojë bazueshmërinë e pretendimit të kërkuesit, ajo duhet të vlerësojë paraprakisht nëse ai ka shteruar të gjitha mjetet juridike që kishte në dispozicion për mbrojtjen e të drejtës së tij për proces të rregullt ligjor.

13. Në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, shterimi i mjeteve të ankimit në gjykatat e zakonshme është një kusht, i cili bën të mundur juridiksionin kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt. Në këtë mënyrë, ky rregull përbën një aspekt të rëndësishëm të parimit se procedura e zgjidhjes së ankesave individuale përpara Gjykatës Kushtetuese është plotësuese (subsidiare) e gjykimit në gjykatat e zakonshme lidhur me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese (parimi i subsidiaritetit). Shterimi, nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 17, datë 18.07.2005*).

14. Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka vlerësuar se shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*vendimet nr.6, datë 31.03.2006 dhe nr.27, datë 20.06.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Shterimi i mjeteve të ankimit është trajtuar edhe nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, e cila në çështjen "Qufaj kundër Shqipërisë" është shprehur se ankuesit duhet të përdorin mjetet ligjore që, sipas sistemit juridik të brendshëm, janë zakonisht në dispozicion të palëve dhe të mjaftueshme për të vënë në vend të drejtat e shkelura.

15. Shterimi i mjeteve është parakusht që duhet përmbushur nga ankuesi i cili, para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura.

16. Gjykata vëren se në zbatim të paragrafit të dytë të nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata e Apelit, më kërkesë të palëve ose kryesisht, mund të përsërisë pjesërisht ose tërësisht hetimin gjyqësor si dhe mund të marrë prova të reja. Mbështetur në procesverbalet e seancave gjyqësore të gjykimit të çështjes pranë Gjykatës së Apelit Tiranë (datë 13.09.2011 dhe datë 04.10.2011) Gjykata Kushtetuese vëren se kërkuesi nuk ka ushtruar të drejtën që i njihej nga neni 465 i Kodit të Procedurës Civile për të kërkuar ripërsëritjen e hetimit gjyqësor ose administrimin e ndonjë prove të re.

17. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet në paraqitjen e pretendimit rreth cenimit të parimit të barazisë së armëve si rezultat i mohimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë të mundësisë së marrjes apo paraqitjes së provave, pasi ai nuk ka shteruar mjetet që kishte në dispozicion për mbrojtjen e tij.

18. Më tej, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit, sipas të cilit është cenuar parimi i barazisë së armëve për shkak se nuk i është dhënë përgjigje disa pretendimeve të tij, është i pabazuar prandaj duhet rrëzuar.

19. Gjykata Kushtetuese ka theksuar dhe më parë në jurisprudencën e saj se gjykatat nuk janë të detyruara t'i japin përgjigje çdo pretendimi të parashtruar nga palët, pasi arsyetimi i vendimit varet nga natyra e çështjes dhe nga rrethanat e saj *(shih vendimin nr.23, datë 04.11.2008 dhe vendimin nr.35, datë 25.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

20. Gjykata vlerëson se në vendimin objekt kërkese të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë parashtruar argumentet përcaktuese për zgjidhjen e çështjes dhe janë shpjeguar mjaftueshëm arsyet e

themelit të dhënies së vendimit, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të subjekteve në gjykim.

21. Për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit duhet rrëzuar.

***B. Mbi pretendimin për mbledhjen e provave në mënyrë të jashtëligjshme***

22. Kërkuesi pretendon se gjatë gjykimit të çështjes pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është zhvilluar një proces i parregullt ligjor për shkak se ekspertët, në hartimin e aktit të ekspertimit, janë bazuar në disa standarde dhe dokumente të cilat nuk janë administruar gjatë procesit gjyqësor si dhe në disa harta numerike të marra nga interneti në kundërshtim me ligjin nr. 10273, datë 29.04.2010 "Për dokumentin elektronik".

23. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile, lejojnë marrjen e provave dhe bëjnë çmuarjen e tyre. Gjykata Kushtetuese, në vendimmarrjen e saj është shprehur se ky funksion është atribut i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, i cili nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese (*shih vendimin nr. 23, datë 17.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e fundit mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugët dhe mënyrën e marrjes së provave dhe të fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit të tyre (*shih vendimin nr.7, datë 27.04.2005 të Gjykatës Kushtetuese)*.

24. Kërkuesi argumenton se ekspertët nuk duhej të mbështesnin ekspertimin e tyre mbi standarde ndërkombëtare të cilat nuk ishin administruar në cilësinë e provës.

25. Në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Civile gjykatat mund të thërrasin një ose më shumë ekspertë, kur për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim kërkohen njohuri të posaçme në fushat e shkencës ose teknikës. Në përfundim të detyrës, eksperti pasqyron arritjet e tij, së bashku me faktet mbi të cilat janë mbështetur këto arritje, në një akt ekspertimi që administrohet nga gjykata përkatëse në cilësinë e provës. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se provat e pretenduara nga kërkuesi si të pa administruara në dosjen gjyqësore, në fakt, janë administruar nëpërmjet aktit të ekspertimit.

26. Për pasojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit në këtë drejtim është i pabazuar.

27. Në mbështetje të pretendimit të tij kërkuesi argumenton, gjithashtu, se ekspertët kanë përdorur harta numerike të marra nga interneti, në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 10273, datë 29.04.2010 "Për dokumentin elektronik".

28. Gjykata Kushtetuese e gjen këtë pretendim haptazi të pabazuar për shkak se, në aspektin procedural, akti i ekspertimit mban datën 01.10.2009. Rrjedhimisht, akti i ekspertimit rezulton se është paraqitur në gjykatë përpara se të hynte në fuqi ligji nr. 10273, datë 29.04.2010 "Për dokumentin elektronik".

29. Për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për mbledhjen e provave në mënyrë të jashtëligjshme, është i pabazuar dhe si i tillë duhet rrëzuar.

***C. Mbi cenimin e parimit të kontradiktoritetit dhe të drejtës së mbrojtjes në gjykim***

30. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke pranuar kërkimet e reja të paraqitura nga subjekti i interesuar në parashtrimet e tij përfundimtare, ka cenuar parimin e kontradiktoritetit, për shkak se i ka mohuar atij mundësinë për të kundërshtuar këto pretendime të reja. Sipas tij, në kundërshtim me nenin 309 të Kodit të Procedurës Civile, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vënë në themel të vendimit të saj të gjitha kërkimet e subjektit të interesuar parashtruar në pretendimet përfundimtare. Në këtë mënyrë gjykata është mbështetur mbi fakte që nuk janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor.

31. Gjykata Kushtetuese ka tashmë një praktikë të konsoliduar sipas së cilës parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit kërkon që në çështjet civile secilës palë në gjykim t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të paraqitur pretendimet e veta sipas kushteve të cilat nuk e vendosin në dizavantazh ndaj kundërshtarit. Secila palë duhet të ketë mundësi që të komentojë mbi të gjitha provat ose parashtrimet e paraqitura, me qëllim që të ndikojë në vendimmarrjen e gjykatës (*shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 25.7.2011*).

32. Gjykata, nga shqyrtimi i akteve ndodhur në dosjen gjyqësore, vlerëson se ky parim nuk është cenuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila i ka krijuar të gjitha mundësitë kërkuesit për të paraqitur pretendime dhe prova apo për të kundërshtuar ato të palës tjetër.

33. Gjykata vëren se hetimi gjyqësor është mbyllur në seancën e datës 01.12.2010. Në atë datë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka administruar provat dhe ka caktuar datën për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare. Në seancën e datës 13.12.2010, rezulton se subjekti i interesuar ka lexuar pretendimet e tij përfundimtare dhe kërkuesi ka qenë prezent. Kërkuesi ka parashtruar me shkrim pretendimet e tij përfundimtare në seancën e datës 21.12.2010.

34. Gjykata vlerëson se meqenëse kërkuesi ka qenë prezent në seancën e datës 13.12.2010, ai kishte mundësi që të kundërshtonte pretendimet e reja të subjektit të interesuar në parashtrimet e tij përfundimtare që dorëzoi në seancën e datës 21.12.2010. Gjykata vëren se kërkuesi e ka përdorur këtë mundësi, pasi ai i ka kundërshtuar këto pretendime të reja (faqet 599-600 të volumit I të dosjes gjyqësore). Kërkuesi nuk rezulton të ketë kërkuar riçeljen e hetimit gjyqësor me qëllim paraqitjen e ndonjë prove të re.

35. Më tej, Gjykata vëren se kërkuesi ka pasur mundësinë për të kërkuar që Gjykata e Apelit Tiranë të korrigjojë këto shkelje të pretenduara prej tij. Në përputhje me nenin 465 të Kodit të Procedurës Civile, gjatë gjykimit të çështjes, gjykata e apelit mund të përsërisë tërësisht apo pjesërisht hetimin gjyqësor. Në zbatim të kësaj dispozite, kërkuesi edhe përpara Gjykatës së Apelit Tiranë gëzonte të drejtën për të kundërshtuar pretendimet e subjektit të interesuar, apo për të paraqitur prova të reja.

36. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se nuk është cenuar parimi i kontradiktoritetit, pasi kërkuesi ka pasur mundësinë për të kundërshtuar pretendimet e subjektit të interesuar dhe e ka ushtruar këtë mundësi gjatë gjykimit të çështjes pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për pasojë, ky pretendim është i pabazuar.

***Ç. Mbi pretendimin e cenimit të së drejtës për të marrë pjesë në gjykim***

37. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Rrethit Tiranë nuk e ka njoftuar për seancat e datës 27.12.2010 dhe 05.01.2011, duke i mohuar kështu të drejtën për të marrë pjesë në gjykim.

38. Gjykata vlerëson se e drejta e palëve për të qenë të pranishme dhe për t'u mbrojtur në procesin gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt, në kuptimin kushtetues. Kjo e drejtë i ngarkon autoritetet me detyrat që të njoftojnë, në kohë të mjaftueshme, palët dhe mbrojtësit e tyre për datën dhe vendin e mbajtjes së procedurave gjyqësore, për të kërkuar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar ata padrejtësisht nga gjykimi. Kjo është tashmë një praktikë e njohur dhe e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas së cilës do të ishte pavlerë përshkrimi në detaje i garancive proceduriale të palëve në proces në rast se atyre nuk do t'u sigurohej ajo që në fakt bën të mundur respektimin e këtyre të drejtave dhe që është pjesëmarrja në gjykim *(shih vendimin nr.42, datë 29.09.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

39. Mbështetur në aktet ndodhur në dosjen gjyqësore, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në zbatim të nenit 302 të Kodit të Procedurës Civile, në seancën e datës 01.12.2010, ka vendosur administrimin e provave dhe mbylljen e hetimit gjyqësor duke ftuar palët të paraqesin pretendimet e fundit. Kjo gjykatë, pasi ka dëgjuar pretendimet përfundimtare në seancat e datës 13.12.2010 (nga subjekti i interesuar) dhe 21.12.2010 (nga kërkuesi), në zbatim të nenit 305 të Kodit të Procedurës Civile, ka deklaruar tërheqjen e saj në dhomën e këshillimit për të dhënë vendimin përfundimtar. Pas kësaj tërheqjeje nuk është paraqitur asnjë provë e re apo zhvilluar ndonjë veprim gjykimi, për shkak se palët nuk kanë ushtruar të drejtën e njohur nga neni 304 i Kodit të Procedurës Civile për të kërkuar çeljen e hetimit gjyqësor. Palët kanë qenë në pritje të vendimit për dhënien e të cilit janë zhvilluar seancat e datës 24.12.2010, 27.12.2010 dhe 05.01.2011. Kërkuesi rezulton se ka pasur dijeni për seancën e datës 24.12.2010 megjithatë ka zgjedhur, pa parashtruar ndonjë shkak ligjor, të mos paraqitet. Në këto kushte, përderisa në seancat e sipërcituara nuk është kryer asnjë veprim gjykimi, pasi palët ishin vetëm në pritje të vendimit, Gjykata vlerëson se kërkuesit nuk i është cenuar e drejta për të marrë pjesë në gjykim.

40. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuesit është i pabazuar dhe si i tillë duhet rrëzuar.

***D. Mbi cenimin e të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme***

41. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk mund të cilësohet si një gjykatë e paanshme, në kuptim të testit objektiv, pasi nuk ka pasqyruar togfjalëshin "në shumën 275 256 834 lekë" në objektin e padisë të paraqitur në vendimin e saj, edhe pse ky togfjalësh figuron në objektin e padisë siç është ngritur nga subjekti i interesuar. Gjithashtu, në mbështetje të këtij pretendimi kërkuesi argumenton se gjatë gjykimit ajo gjykatë ka pranuar të gjithë kërkesat e subjektit të interesuar madje duke shtyrë edhe tre herë shpalljen e vendimit vetëm për t'i dhënë mundësi subjektit të interesuar për të paguar diferencën e taksës gjyqësore. Ndërsa kërkuesit i ka mohuar marrjen e provave nga organet tatimore, ka mohuar mundësinë për të paraqitur provat e reja të kërkuara nga ekspertët në lidhje me kundërpadinë si dhe nuk ka kryer njoftimet për seancat.

42. Gjykata thekson, se është e një rëndësie themelore në një shoqëri demokratike që gjykatat të frymëzojnë besim tek publiku dhe, mbi të gjitha, tek palët në proces. Për këtë qëllim neni 42 i Kushtetutës kërkon që një gjykatë, e cila përfshihet në sferën e veprimit të tij, të jetë e paanshme. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet *(shih vendimin nr.38, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese)*.

43. Me këtë rast, Gjykata përsërit se respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet, duke zbatuar testin objektiv me të cilin shqyrtohet, nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë dhe testin subjektiv që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose të interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar *(shih vendimet: nr.7, datë 11.03.2008; nr.11, datë 02.04.2008; nr.23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese)*. Nga pikëpamja e testit objektiv të paanshmërisë, kur shqyrtohet nëse në një çështje të caktuar ekziston një arsye e ligjshme për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm *(shih vendimin nr.10, datë 02.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese)*.

44. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pohuar se "… Gjykata ka evidentuar dallimin midis kriterit subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit që bindja personale ose interesi i një gjyqtari kanë ndikuar në vendimin e gjykatës, dhe kriterit objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse ai apo ajo ofruan garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm", si dhe "… fakti i thjeshtë që gjyqtari ka marrë vendim, në vetvete nuk mjafton për të mbështetur dyshimet rreth paanshmërisë së tij. Ajo që ka rëndësi është qëllimi dhe natyra e veprimeve që kryen ai gjatë procesit gjyqësor" *(shih vendimin Gjonboçari kundër Shqipërisë, datë 31 mars 2005*).

45. Në përputhje me standardet e mësipërme Gjykata vlerëson se elementet e paraqitura nga kërkuesi, në mbështetje të pretendimit të tij, janë të pamjaftueshme për të krijuar dyshime të përligjura rreth paanshmërisë objektive të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

46. Gjykata vëren se kërkuesi në mbështetje të pretendimit të tij sjell argumente që i referohen shkeljeve të shqyrtuara më sipër nën dritën e standardeve të ndryshme të procesit të rregullt ligjor. Siç është theksuar gjatë shqyrtimit të këtyre pretendimeve, Gjykata Kushtetuese vlerëson se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ka cenuar standardet kushtetuese të procesit të rregullt ligjor.

47. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit është i pabazuar dhe duhet rrëzuar.

***DH. Mbi cenimin e standardit kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore***

48. Kërkuesi pretendon se vendimet objekt kërkese janë kontradiktore në përcaktimin e faktit se kur është vënë në shfrytëzim kompleksi turistik si dhe i kanë dhënë subjektit të interesuar edhe çmimin e kontratës, edhe kushtin penal ndërkohë që kjo gjë ndalohet shprehimisht nga neni 542 i Kodit Civil.

49. Gjithashtu, kërkuesi argumenton se vendimi përfundimtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues, por vetëm nga kryesuesja E. Ll.

50. Sipas kërkuesit, vendimet objekt kërkese kanë shkelur standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore edhe për faktin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë nuk i kanë dhënë përgjigje disa pretendimeve të kërkuesit.

51. Në mbështetje të këtij pretendimi kërkuesi argumenton, po kështu, se Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim kontradiktor, pasi me vendimin nr. 436, datë 18.11.2011 ka vendosur pezullimin e zbatimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndërkohë që më pas ka vlerësuar se rekursi nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

52. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik. Një arsyetim i saktë i vendimit është një mënyrë e sigurt që gjeneron legjitimitet në sytë e të interesuarve. Ky efekt do të jetë akoma më i madh nëse palët do ta përjetojnë këtë vendim si pasojë normale e një procesi të rregullt, në të gjithë komponentët e tij.

53. Nga ana tjetër, pjesa urdhëruese e vendimit të gjykatës duhet të jetë rezultat i natyrshëm i përfundimeve të arritura në pjesën arsyetuese. Ajo është sintezë e këtyre përfundimeve dhe si e tillë, në asnjë rast, nuk mund të jetë në kundërshtim me to. Një vendim i plotë dhe i kuptueshëm pasohet logjikisht edhe me vetë forcimin e sistemit gjyqësor. Ai kontribuon në shprehjen dhe thellimin e vlerave shoqërore që transmetohen përmes normave ligjore.

54. Në përputhje me standardin e mësipërm, Gjykata vlerëson se vendimet objekt kërkese nuk përmbajnë kontradikta që do të mund t'i bënin këto vendime të paarsyetuara, në kuptimin kushtetues.

55. Konkretisht, Gjykata vëren se vendimi objekt kërkese i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është kontradiktor për sa i takon datës së vënies në shfrytëzim të kompleksit turistik. Mbështetur në këtë vendim, faqja 14, kjo gjykatë vetëm sa përmend provat, për periudhën nga viti 2005 e në vazhdim, në bazë të të cilave provohet se kompleksi është vënë në shfrytëzim të paktën nga ajo datë. Ndërsa në faqen 15 kjo gjykatë shprehet së kërkuesi shfrytëzon i vetëm kompleksin që nga viti 2003.

56. Gjykata vlerëson se nuk ka kontradiktë midis këtyre thënieve, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është e qartë në vendimin e saj se kompleksi shfrytëzohet prej vitit 2003. Konstatimet e kësaj gjykate, të shprehura në faqen 14 të vendimit, se kompleksi është vënë në shfrytëzim të paktën që prej vitit 2005, janë një përfundim i ndërmjetëm rrjedhojë e analizës së provave të listuara në po atë faqe. Rrjedhimisht, vendimi objekt kërkese i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është kontradiktor për sa i përket datës së vënies në shfrytëzim të kompleksit turistik.

57. Kërkuesi argumenton, gjithashtu, se vendimet objekt kërkese janë të paarsyetuara për shkak se janë marrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 542 të Kodit Civil. Në shqyrtimin e këtij pretendimi Gjykata vlerëson të nevojshme të përsërisë qëndrimin e saj konstant se, në kuadër të kontrollit që ajo ushtron në zbatim të nenit 131/f të Kushtetutës, çështjet e interpretimit të ligjit hyjnë në juridiksionin kushtetues vetëm nëse dhe për aq sa ky interpretim ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

58. Në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese ka pranuar, në mënyrë të vazhdueshme, se ajo ndërhyn në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 dhe 131, shkronja "f" e Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 14, datë 3.6.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

59. Në përputhje me qëndrimin e mësipërm Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete argumenti i kërkuesit i takon mirëfilli interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme të cilat, sipas tij,

kanë shkelur nenin 542 të Kodit Civil. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk e ngre pretendimin e tij në nivel kushtetues.

60. Argumentin e kërkuesit se vendimi përfundimtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është nënshkruar nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues, Gjykata e vlerëson haptazi të pabazuar. Gjykata vëren se në dosjen gjyqësore ndodhet një vendim, në shkronja korsive, i cili është i nënshkruar nga të tre anëtarët e trupit gjykues.

61. Më tej, të pabazuar Gjykata e gjen edhe pretendimin se vendimet objekt kërkese janë të paarsyetuara për shkak se nuk i kanë dhënë përgjigje disa pretendimeve të kërkuesit.

62. Gjykata ka theksuar se edhe pse neni 142 i Kushtetutës i detyron gjykatat të arsyetojnë vendimet e tyre, kjo nuk mund të kuptohet sikur kërkohet një përgjigje e detajuar për çdo argument *(shih vendimin nr.23, datë 04.11.2008 dhe vendimin nr. 35, datë 25.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*.

63. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në vendimin e tyre kanë arritur të shpjegojnë mjaftueshëm arsyet e themelit të dhënies së vendimit, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të subjekteve në gjykim, çka ka përmbushur përgjithësisht detyrimin për arsyetimin e vendimit gjyqësor, sanksionuar në nenin 142 të Kushtetutës.

64. Kërkuesi argumenton gjithashtu se Gjykata e Lartë ka mbajtur një qëndrim kontradiktor në gjykimin e çështjes, pasi edhe pse ka pezulluar ekzekutimin e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vlerësuar, në dhomë këshillimi, se rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

65. Gjykata vlerëson se pezullimi i ekzekutimit të një vendimi gjyqësor nga Gjykata e Lartë, në zbatim të kompetencave që i njihen nga neni 479 i Kodit të Procedurës Civile, nuk presupozon asnjë vlerësim nga ajo gjykatë të themelit apo shkaqeve të rekursit, por vetëm të kushteve të parashikuara në atë dispozitë procedurale.

66. Vlerësimi dhe analiza nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit bëhet nga Gjykata e Lartë, në dhomë këshillimi, e cila, në rast se krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, ka në kompetencë të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore.

67. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se nuk ka asnjë kontradiktë në qëndrimin e Gjykatës së Lartë dhe për këtë arsye pretendimi i kërkuesit, i mbështetur mbi këtë argument, është i pabazuar.

68. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se vendimet objekt kërkese nuk janë marrë në cenim të standardit kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore dhe, për këtë arsye, pretendimi i kërkuesit është i pabazuar.

**E. Mbi cenimin e parimit të sigurisë juridike**

69. Kërkuesi pretendon se gjykatat, duke mos respektuar vendimin unifikues nr. 9, datë 9.3.2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë cenuar parimin e pritshmërisë së ligjshme dhe barazisë në të drejta.

70. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjeve është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos e Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Ky funksion ushtrohet nga Gjykata e Lartë duke tërhequr për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara. Sa më sipër vjen si pasojë e pozicionit të saj si organi më i lartë i sistemit gjyqësor dhe lidhet me funksionin e përgjithshëm të saj për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit të cilave gjyqtarët duhet t'u përmbahen. Përfundimet në të cilat arrin Gjykata e Lartë nuk vlejnë vetëm për rastin konkret të zgjidhur prej saj, por për të gjitha rastet e ngjashme për gjykatat e tjera, ose vetë kolegjet e thjeshta të asaj gjykate. Barazia në të drejta, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme në çështje të ngjashme nga gjykatat e zakonshme (*shih vendimin nr. 6, datë 17.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

71. Gjykata thekson se standardi i mësipërm nuk duhet kuptuar si një mënyrë që kjo Gjykatë të ndërhyjë në veprimtarinë dhe kompetencat e gjykatave të tjera. Veprimtaria gjyqësore konsiston në

zbatimin e dispozitës ligjore (e hartuar përgjithësisht në terma të përgjithshëm dhe abstraktë) në një çështje specifike konkrete. Në ushtrimin e veprimtarisë së tyre gjyqësore gjykatat, në funksion të fakteve dhe çështjes konkrete, përcaktojnë nëse çështja që duhet të zgjidhin është e ngjashme me çështje të zgjidhura më parë nga Gjykata e Lartë nëpërmjet një vendimi unifikues.

72. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se kërkuesi, në të vërtetë, i kërkon që të verifikojë interpretimin e rrethanave dhe fakteve që gjykatat e tjera kanë bërë. Gjykata është shprehur dhe më sipër se nuk bën rivlerësimin e fakteve e rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga neni 42 dhe 131, shkronja "f" e Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues.

73. Në çështjen konkrete, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit i referohet rivlerësimit të fakteve dhe rrethanave të bëra nga gjykatat e zakonshme dhe si i tillë duhet rrëzuar.

**Ë.** ***Mbi cenimin e parimit të disponibilitetit të padisë***

74. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shkelur parimin e disponibilitetit, duke ndryshuar bazën ligjore të padisë pa pasur një kërkesë nga palët në proces si dhe duke u shprehur tej kërkimeve që ka përcaktuar subjekti i interesuar në tri pikat e para të objektit të kërkesëpadisë.

75. Parimi i disponibilitetit është një parim i rëndësishëm procedural civil i cili parashikohet në nenin 2 të Kodit të Procedurës Civile. Iniciativa për të filluar procesin i takon paditësit, sepse gjykata nuk procedon vetë dhe nuk merr në shqyrtim një mosmarrëveshje nëse këtë nuk e kërkon i interesuari - "Vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën për fillimin e një procesi gjyqësor, përveç kur ligji parashikon ndryshe" (neni 2 i Kodit të Procedurës Civile). Në çdo rast është pala që përcakton objektin e gjykimit, kështu që gjykata nuk mund të dalë jashtë objektit të padisë. Pra, në përputhje me nenin 6 të Kodit të Procedurës Civile "gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet" (*shih vendimin nr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

76. E drejta për të disponuar mbi objektin e padisë është një e drejtë e paditësit, i cili e ushtron duke bërë ndryshimet, shtesat apo pakësimet e objektit të padisë sipas interesave të tij. Gjykata nuk mund të diktojë objektin e padisë dhe as të pengojë paditësin në ushtrimin e të drejtës për të disponuar mbi këtë objekt (*shih vendimin nr.6, datë 15.04.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

77. Pretendimet që kanë të bëjnë me shkeljen e parimit të disponibilitetit, janë trajtuar gjerësisht në jurisprudencën kushtetuese, si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

78. Parimi i disponibilitetit të padisë është analizuar bashkërisht dhe në funksion të standardeve të tjera kushtetuese. Konkretisht, Gjykata ka analizuar parimin e disponibilitetit të padisë nën dritën e barazisë së armëve në proces, të së drejtës për t'u dëgjuar dhe të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme (*shih vendimet nr.6, datë 15.04.2005; nr. 31, datë 01.12.2005; nr. 20, datë 02.07.2003 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka analizuar këtë parim, nën dritën e të drejtës së aksesit në gjykatë, duke vlerësuar se një kërkues nuk legjitimohet *ratione personae* në ngritjen e pretendimit për cenim të parimit të disponibilitetit në rast se objekti i gjykimit përcaktohej nga një palë tjetër (*shih vendimin nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

79. Në përputhje me qëndrimin e saj konstant Gjykata vlerëson se pretendimi për cenim të parimit të disponibilitetit të padisë duhet të trajtohet nën dritën e pretendimeve që kërkuesi parashtroi më sipër për cenimin e standardeve të procesit të rregullt ligjor. Këto pretendime, siç u analizuan më parë, nuk rezultuan të bazuara. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se edhe pretendimi për cenimin e parimit të disponibilitetit të padisë është i pabazuar dhe duhet rrëzuar.

**F. Mbi pretendimet e tjera**

80. Kërkuesi në pikën 3 të objektit të kërkesës i drejtohet Gjykatës me qëllim detyrimin e disa subjekteve për të kryer disa veprime të caktuara. Gjykata vëren se në kompetencat e parashikuara në nenin 132 të Kushtetutës ajo ka vetëm të drejtën e shfuqizimit të akteve që shqyrton.

81. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se pika 3 e objektit të kërkesës nuk është në kompetencë të saj dhe, për këtë arsye, kërkuesi nuk legjitimohet në paraqitjen e saj.

82. Më tej, kërkuesi pretendon se Gjykata e Lartë duhej të kalonte çështjen për shqyrtim në seancë, në mënyrë që të mbante një qëndrim të shprehur rreth pretendimeve të ngritura në rekurs.

83. Gjykata Kushtetuese është shprehur në mënyrë konstante se është kompetencë e Kolegjit Civil (dhoma e këshillimit) të analizojë dhe vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me kërkesat e ligjit. Në rast se Kolegji, në dhomën e këshillimit, krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, atëherë është në kompetencën e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Në përputhje me standardin e mësipërm, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit është i pabazuar dhe duhet rrëzuar.

84. Për sa më sipër, Gjykata Kushtetuese vlerëson se pretendimet e kërkuesit rreth zhvillimit të një procesi të parregullt ligjor, nuk janë të bazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Xhezair Zaganjori, Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Sokol Berberi, Vitore Tusha, Admir Thanza
Anëtar kundër: Fatmir Hoxha

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, për sa i takon rrëzimit të kërkesës së paraqitur nga shoqëria "KLA & XHU" sh.p.k., e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice. Në rastin konkret, kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shkelur parimin e disponibilitetit të padisë, për shkak se është shprehur tej objektit të padisë. Shumica, nëpërmjet arsyetimit të saj, ka vlerësuar se pretendimi për cenim të parimit të disponibilitetit të padisë duhet të trajtohet nën dritën e pretendimeve të tjera të ngritura prej kërkuesit. Me fjalë të tjera, shumica vlerëson se parimi i disponibilitetit të padisë nuk ka një ekzistencë autonome si standard i procesit të rregullt ligjor, por duhet parë në funksion të standardeve të tjera të kësaj të drejte. Për pasojë, shumica ka vlerësuar se ky pretendim duhet rrëzuar.

2. Nuk pajtohem me këtë qëndrim të shumicës për arsyet që do të parashtroj më hollësisht në vijim.

3. Parimi i disponibilitetit është shqyrtuar dhe shtjelluar nga Gjykata Kushtetuese në disa vendime.

4. Kështu, në vendimin nr. 7, datë 09.03.2009, Gjykata është shprehur se pretendimet që kanë të bëjnë me shkeljen e parimit të disponibilitetit, janë trajtuar gjerësisht në jurisprudencën kushtetuese, si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në gjykimet kushtetuese të kësaj natyre, kur janë konstatuar raste të tejkalimit nga ana e gjykatave të kërkesave të parashtruara në një padi, ato janë konsideruar nga Gjykata Kushtetuese si elemente thelbësore që cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

5. Në analizë të trajtimit të parimit të disponibilitetit të padisë nga Gjykata Kushtetuese, arrihet në përfundimin, në mënyrë të përmbledhur, se ky parim përfshihet tek e drejta kushtetuese për proces të

rregullt ligjor, se gjykatat nuk mund të mos shprehen për të gjithë objektin e padisë, por, gjithashtu, nuk mund të tejkalojnë as bazën juridike të padisë dhe as kufijtë e objektit të padisë. E drejta për të ndryshuar bazën ligjore apo objektin e padisë i takon vetëm palëve të cilat mund ta ushtrojnë në përputhje me rregullat procedurale në fuqi (neni 185 i Kodit të Procedurës Civile).

6. Duke zbatuar këto standarde, në çështjen konkrete rezulton se ka një ndryshim të vlerës së objektit të padisë.

7. Konkretisht, referuar dosjes gjyqësore (Vol I - fq. 1) vërej se subjekti i interesuar ka ngritur një padi me objekt: "*1- Detyrimin e të paditurës "Kla & Xhu" SHPK, të paguajë vlerën e punimeve të realizuara sipas kontratës nr. 3751 Rep. dhe nr. 892 Kol., datë 26.6.2003, në shumën 275.256.834 lekë."*

8. Ky kërkim është përsëritur në fund të padisë (fq. 9 e dosjes gjyqësorë) ku është kërkuar detyrimi i kërkuesit që të paguajë "*vlerën e punimeve të realizuara sipas kontratës nr. 3751 Rep. dhe nr. 892 Kol., datë 26.6.2003, në shumën 275.256.834 lekë."* Gjithashtu, ky kërkim është përsëritur në shpjegimet e subjektit të interesuar (fq. 531 e dosjes gjyqësore). Po kështu, në aktin "kundërshtim i aktit të ekspertimit", datë 9.6.2010, subjekti i interesuar pretendon (fq. 545 e dosjes gjyqësore) se vlera e punimeve e kryer prej tij është 274.475.370 lekë. Më tej, në kërkimet përfundimtare, subjekti i interesuar ka përsëritur (fq. 559 e dosjes gjyqësore) pikën e parë të objektit të padisë duke përfshirë togfjalëshin "*në shumën 275.256.834 lekë*", por më tej (fq. 569 e dosjes gjyqësore) e ka cituar këtë pikë pa atë togfjalësh. Megjithatë, në kundërshtim me parashtrimet e mësipërme, subjekti i interesuar, në pretendimet e tij përfundimtare, është shprehur (fq. 565-567 të dosjes gjyqësore) se kërkon kalimin në pronësi të ½-ës së kompleksit turistik si çmim i kontratës dhe jo shumën 275.256.834 lekë.

9. Referuar vendimit nr. 2, datë 05.01.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (fq. 1), vërej se objekti i padisë në këtë vendim paraqitet me mangësi në pikën e parë, konkretisht nuk janë pasqyruar fjalët "*në shumën 275.256.834 lekë"*. Kjo mangësi është ripërsëritur në vendim (fq. 3 dhe 23, paragrafi i fundit) dhe është vënë në themel të arsyetimit të kësaj gjykate për të dhënë në natyrë ½-ën e kompleksit turistik (shih veçanërisht fq. 18 dhe 24, paragrafi i parë dhe i dytë i vendimit). Gjykata e Apelit Tiranë ka ndjekur të njëjtin arsyetim, duke pasqyruar objektin e padisë të paplotë (fq. 34 e vendimit) dhe duke e vendosur këtë mangësi në themel të rrëzimit të pretendimit të kërkuesit për cenim të parimit të disponibilitetit (fq. 35 e vendimit).

10. Nga aktet ndodhur në dosje: procesverbali i seancës së datës 19.05.2010 (fq. 499 dhe 500 të Vol. I të dosjes gjyqësore), fletëthirrja e datës 19.05.2010 (fq. 367 e Vol. I të dosjes gjyqësore), rezulton se Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i është paraqitur, nga subjekti i interesuar, një kërkese për shtim objekti të padisë, nga e cila është hequr dorë në seancën e datës 09.06.2010.

11. Mbështetur në procesverbalet e seancave dhe në materialet e dosjes gjyqësore, rezulton se subjekti i interesuar nuk ka paraqitur në asnjë moment kërkesë për ndryshim të objektit të padisë, veçanërisht duke kërkuar heqjen e fjalëve "*në shumën 275.256.834 lekë*" nga kërkimi i parë i objektit të padisë.

12. Përcaktimi i kësaj shume kufizonte vendimmarrjen e gjykatave të cilat, nëse pranonin këtë kërkim për pagimin e punimeve sipas kontratës së sipërmarrjes, nuk mund të jepnin më shumë se vlera e mësipërme (275.256.834 lekë).

13. Për këtë arsye, edhe nëse çmimi i kontratës së sipërmarrjes ishte ½ e kompleksit dhe kjo ½ ishte në vlerë më e madhe se kërkimi i subjektit të interesuar, atëherë gjykatat mund të jepnin maksimalisht vlerën e kërkuar në padi (pra 275.256.834 lekë). Subjekti i interesuar, për shkak se në cilësinë e paditësit duhej të parapaguante taksën gjyqësore, kishte një arsye shumë të fortë për të kërkuar pagimin e vetëm të shumës 275.256.834 lekë në vend të ½-ës së kompleksit. Duke kërkuar vetëm këtë shumë ai mund të ngrinte padi duke paguar një taksë gjyqësore më të vogël. Në këtë mënyrë paditësi minimizonte humbjet në rast rrëzimi të padisë, pasi kjo taksë e parapaguar nuk do të rikthehej. Pra, vlera e përcaktuar në pikën e parë të objektit përbën një tavan ose kufi maksimal, i cili nuk mund të tejkalohet edhe në rast se pala kishte të drejtë të kërkonte një vlerë më të madhe.

14. Gjatë procesit, neni 185 i Kodit të Procedurës Civile i njeh mundësinë palës paditëse që të saktësojë apo ndryshojë objektin e padisë, por gjithmonë duke respektuar disa kërkesa procedurale,

veçanërisht detyrimin që ky ndryshim të bëhet vetëm gjatë hetimit gjyqësor. Nëse ndryshimi bëhet jashtë këtij parashikimi, atëherë ai nuk mund të prodhojë efekte juridike pasi nuk është i vlefshëm.

15. Mbështetur në dosjen gjyqësore (cituar më sipër) vërej se nuk ka asnjë provë apo pretendim që pika 1 e objektit të padisë të jetë ndryshuar në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore. Për këtë arsye, vlerësoj se gjykatat, duke dhënë në natyrë ½-ën e kompleksit, kanë disponuar *ultra petita*, duke shkelur kështu parimin kushtetues të disponibilitetit të padisë.

16. Më tej, mbështetur në dosjen gjyqësore, vërej se subjekti i interesuar ka paraqitur, vetëm në parashtrimet përfundimtare, argumentin (fq. 567 e dosjes gjyqësore) se midis tij dhe kërkuesit është krijuar një shoqëri e thjeshtë në kuptimin e Kodit Civil.

17. Vlerësoj se ngritja e një pretendimi të një natyre krejt tjetër (ortakë të një shoqërie të thjeshtë) dhe krejtësisht të ndryshëm nga shkaku ligjor që përbënte bazën mbi të cilën është ngritur padia (marrëdhënie kontraktuale sipërmarrjeje) duhej bërë në përputhje me parashikimet e nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile, gjatë hetimit gjyqësor, dhe jo në parashtrimet përfundimtare. Parimi i disponibilitetit të padisë i jep të drejtën paditësit, subjektit të interesuar në çështjen konkrete, që të disponojë si të dojë me padinë, por duke respektuar kërkesat dhe procedurën e nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile. Ndryshimi i shkakut ligjor, pa respektuar kërkesat e nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile, nuk mund të prodhojë efekte dhe nuk mund të merret parasysh nga gjykata.

18. Vlerësoj se gjykatat, në këtë rast, duke u mbështetur mbi bazën ligjore të shoqërisë së thjeshtë që nuk ishte pasqyruar në padi, apo gjatë hetimit, kanë tejkaluar kufijtë e parimit *iura novit curia*. Ky parim, edhe nëse merret në kuptimin e tij më të gjerë përmbledhur në maksimën latine *da mihi factum, dabo tibi ius* (më jepni faktet dhe do t'ju them ligjin) presupozon që gjykata i paraqet palëve ligjin që ajo mendon se është i zbatueshëm, duke u dhënë atyre mundësinë që të debatojnë rreth tij. Në të drejtën shqiptare ky kuptim kaq i zgjeruar i parimit *iura novit curia* nuk ka fuqi juridike, pasi, në përputhje me nenin 72, pika 4 të Kodit të Procedurës Civile, do të ishte i barabartë me dhënien e një mendimi, duke sjellë si pasojë detyrimin e gjyqtarit për t'u dorëhequr nga gjykimi. Vlerësoj se ky parim ka një kuptim të ngushtë duke u zbatuar vetëm në fusha të veçanta të së drejtës, siç është rasti i të drejtave themelore garantuar nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja, apo ligjeve të rendit publik (*ordre public,* përkufizuar si ligje që rregullojnë interesat themelore të shtetit dhe shoqërisë) që kanë një rëndësi të atillë që duhet të zbatohen edhe kryesisht nga gjykata. Në gjykimin e zakonshëm, jashtë parashikimeve të mësipërme, roli i gjykatës është i kufizuar, në përputhje edhe me parimin e disponibilitetit të padisë, vetëm në shqyrtimin dhe vlerësimin e fakteve dhe shkaqeve ligjore të paraqitura përpara saj, në përputhje me normat përkatëse procedurale.

19. Opinioni im mbështetet edhe në qëndrimin e shprehur nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj unifikues nr. 9, datë 09.03.2006, sipas të cilit*"Si përfundim, në kuptim të nenit 16 te Kodit të Procedurës Civile, cilësimi i saktë i fakteve dhe veprimeve (më saktë i ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike), që lidhen me mosmarrëveshjen, bëhet nga gjykata që shqyrton çështjen, ndërsa përcaktimi i bazës juridike të padisë bëhet nga vetë paditësi që me paraqitjen e padisë, dhe është në disponimin e plotë të tij ta ndryshojë atë deri në përfundim të hetimit gjyqësor, duke i bërë kërkesë gjykatës në një formë të përshtatshme procedurale.*

*Në respekt të parimit të ruajtjes së paanësisë në gjykim, gjykata, e cila ka konkluduar në një cilësim juridik të fakteve të çështjes, të ndryshëm nga cilësimi që u ka bërë atyre paditësi nëpërmjet referencës në dispozitën përkatëse të ligjit material, nuk ka të drejtë të imponohet duke ndërhyrë e ndryshuar bazën juridike të padisë të përcaktuar nga paditësi. Në gjykimin civil gjykata nuk ka dhe nuk mund të ketë rol aktiv.*

*Ne nenin 185 të Kodit të Procedurës Civile tërheq vëmendjen përdorimi i termit "shkaku ligjor i padisë", krahas termit "objekti i padisë".*

*Doktrina e së drejtës procedurale civile i ka definuar qartë këto dy elemente kryesore të një padie. Shkaku është arsyeja e kërkimit gjyqësor, i cili ndahet në të drejtën dhe në një gjendje fakti që është kundër kësaj të drejte (causa pretendi), d.m.th. që e shkel, e cenon apo e mohon të drejtën subjektive të paditësit. Nga ana tjetër, objekti është ajo që kërkohet si efekt i padisë, d.m.th. zbatimi i ligjit dhe fitimi i asaj çfarë kërkohet e që vjen si pasojë e zbatimit të ligjit (petitum)."*

20. Rrjedhimisht, vlerësoj se gjykatat kanë shkelur parimin e disponibilitetit të padisë për shkak se janë mbështetur mbi një pretendim të ri të subjektit të interesuar, i cili nuk ishte parashtruar në formën e kërkuar.

21. Vlerësimi i shumicës se parimi i disponibilitetit të padisë nuk ka një ekzistencë autonome si standard i procesit të rregullt ligjor, por duhet parë në funksion të standardeve të tjera të kësaj të drejte është, në mendimin tim, i gabuar. Parimi i disponibilitetit të padisë është një standard më vete i procesit të rregullt ligjor i cili, si në rastin konkret, mund të sjellë pasoja shumë të rënda për një palë në proces.

22. Shqyrtimi i parimit të disponibilitetit të padisë vetëm në bashkim të standardeve të tjera të procesit të rregullt ligjor sjell, në praktikë, mungesën e efektivitetit të nenit 185 të Kodit të Procedurës Civile dhe, si në rastin konkret, një ngushtim në mbrojtjen e të drejtave themelore të individëve. Në mendimin tim ky qëndrim bie ndesh jo vetëm me evolucionin historik të të drejtave të njeriut, si të drejta fusha e të cilave është në zgjerim të përhershëm, por dhe me frymën e Kushtetutës e cila kërkon një mbrojtje sa më të gjerë të të drejtave themelore.

Anëtar: Fatmir Hoxha

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 23.4.2013
Doli nga shtypi më 23.4.2013

| | |
|---|---|
| | Formati: 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 58 lekë